# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6071
E premte, 24 korrik 2020
çmimi 0.40 €


## Kuvendi ratifikoi pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare

FAQE 8




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# S'KA MARRËVESHJE TË VEÇANTA PA MARRËVESHJE GJITHËPËRFSHIRËSE



Kosova dhe Serbia kanë nisur të enjten diskutimet politike në nivel ekspertësh në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve në Bruksel. Takimi i parë në mes të dy delegacioneve është konsideruar konstruktiv, por nuk janë dhënë hollësi se çka është biseduar. Pas këtij takimi, koordinatori shtetëror Skender Hyseni ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje të veçanta me Serbinë përderisa nuk ka marrëveshje gjithëpërfshirëse. Hyseni ka bërë me dije se për t'i trajtuar elementet e veçanta, ose kapitujt e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, duhet kohë FAQE 4-5

## META NË TAKIM ME KOMANDANTIN E FSK-së: KOSOVA MERITON TË JETË ANËTARE E NATO-S

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, në një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralllejtënant Rrahman Rama, ka thënë se Kosova meriton të jetë pjesë e NATO-s. "Kosova plotësisht meriton të jetë sa më parë anëtare e NATO-s dhe do të ketë mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë në këtë drejtim si në të gjitha fushat me interes reciprok e kombëtar", ka thënë Meta FAQE 2





## Krasniqi infektohet me Covid-19, Veseli izolohet, Mustafa shërohet

FAQE 7

## OPINION

### USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS KISHTE TIPARET MË TË SPIKATURA TË NJË USHTRIE TË KOHËS SONË (15)

F. 11

Shkruan: Kudusi LAMA



## AKTUALE

### OSMANI SËRISH PËRPLASET ME DEPUTETËT E LDK-së F. 6

### THAÇI INFORMOHET NGA TËRNAVA PËR NISJEN E NDËRTIMIT TË XHAMISË SË MADHE F. 6

### CHRISTIAN HELDT PËRFUNDON MANDATIN E AMBASADORIT TË GJERMANISË NË KOSOVË F. 6



## EKONOMI



### PROTESTOJNË PUNËTORËT E TELEKOMIT, KËRKOJNË ZGJIDHJE PËR GJENDJEN E KRIJUAR NË KËTË NDËRMARRJE F. 8

### OEAK-u BËN THIRRJE QË POLITIKA TË FOKUSOHET NË SHMANGIEN E KOLAPSIT TË SEKTORIT PRIVAT F. 8


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Lladrovci: Nuk është befasi që Ali Ahmeti është ftuar nga Specialja



PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka deklaruar se nuk është befasi që kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është ftuar si dëshmitar në Gjykatën Speciale në Hagë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se deri me tani të gjithë personalitetet që kontribuuan në UÇK janë ftuar në cilësi të ndryshme për të dëshmuar nga kjo gjykatë. Sipas tij, për 20 vjet po dështon përpjekja për ta barazuar viktimën me kriminelin. "Nuk është befasi që Ali Ahmeti ftohet si dëshmitar në Hagë, për shumë arsye. Ndër to, më e rëndësishmja është se të gjitha personalitetet që ndërtuan dhe kontribuuan për UÇK-në, tashmë janë ftuar në cilësi të ndryshme për të dëshmuar. Për 20 vjet dështon përpjekja për ta barazuar viktimën me kriminelin. Ali Ahmeti, ka çka të dëshmojë për terrorin nga viti 1981 e këndej të tërë aparatit shtetëror represiv serb, deri te mbi 400 varrezat masive të shqiptarëve në Kosovë, gjatë luftës çlirimtare më 1998-1999. Kosova është krenare me bijtë dhe bijat me të devotshme të kombit që i dolën përballë makinerisë vrastare serbe, duke e çliruar Kosovën, së bashku me NATO-n. Vëlla Ali, përgjithmonë mirënjohës e krenar për çdo hap e çdo vepër tënde për Kosovën dhe të drejtat e shqiptarëve!", ka shkruar Lladrovci.

# Meta në takim me komandantin e FSK-së: Kosova meriton të jetë anëtare e NATO-s

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, në një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se Kosova meriton të jetë pjesë e NATO-s. "Kosova meriton plotësisht të jetë sa më parë anëtare e NATO-s dhe do ta ketë mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë në këtë drejtim dhe në të gjitha fushat me interes reciprok e kombëtar", ka thënë Meta



TIRANË, 23 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të enjten në takim komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në këtë takim, ai ka thënë se Kosova meriton të jetë pjesë e NATO-s. "Prita sot në një takim vëllazëror komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralleljtënant Rrahman Rama. Ndamë mendime tepër të vyera në lidhje me domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit mes forcave tona të armatosura, me qëllim përballimin me sukses të sfidave të sigurisë kombëtare që parashtron koha, në funksion të paqes e stabilitetit në rajonin tonë. Kosova e meriton plotësisht të jetë sa më parë anëtare e NATO-s dhe do ta ketë mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë në këtë drejtim si dhe në të gjitha fushat me interes reciprok e kombëtar. I shpreha mirënjohjen e thellë për sakrificat dhe solidaritetin vëllazëror, gatishmërinë e pashoq dhe profesionalizmin e jashtëzakonshëm të treguar nga FSK-ja dhe Kosova jonë e dashur ndaj Shqipërisë, që në çastet e para pas tërmetit të 26 nëntorit 2019", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

Po ashtu, Meta të enjten është takuar edhe me kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, me të cilin ka biseduar për sfidat me të cilat janë duke kaluar Kosova dhe Shqipëria. "Mikprita sot kryetarin e Komunës së Gjilanit, z. Lutfi Haziri. Në bisedën e hapur ndamë mendime rreth sfidave dhe rrugës euroatlantike të Kosovës dhe Shqipërisë, duke u ndalur veçanërisht në domosdoshmërinë e tejkalimit sa më të shpejtë dhe të lehtë të pasojave të pandemisë Covid-19, me afrimin e pikut të sezonit turistik. I përcolla përshëndetjet më të përzemërta vëllazërore për të gjithë bashkëqytetarët e mi të Gjilanit", ka shkruar Meta.

## Kuvendi i Shqipërisë miraton marrëveshjen për reformën zgjedhore

TIRANË, 23 KORRIK - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar marrëveshjen e 5 qershorit, e cila ishte arritur ndërmjet palëve politike për reformën zgjedhore. Kjo marrëveshje është miratuar me votat e 100 deputetëve. Ndërkohë kanë qenë gjashtë deputetë që kanë votuar kundër kësaj marrëveshje të arritur më 5 qershor, ndërsa 3 deputetë të tjerë kanë abstenuar. Marrëveshja mund të kalonte edhe me 84 vota, por Partia Socialiste ka firmosur marrëveshjen me opozitën parlamentare pak ditë më parë.

Me këtë rast, kryeministri Edi Rama ka thënë se kjo marrëveshje është detyrim për të gjitha palët. "Jemi edhe parti më vete, edhe jemi koalicion. E pyesim ku ekziston? Na thonë në një libër. Po pse ta kemi ne? Zgjedhësit votojnë një tren ku duket lokomotiva dhe ngjyra dhe pastaj vagonët janë me dritaret e mbyllura. S'dihet çfarë kanë brenda. Dhe votat kalojnë nga vagoni në vagonin tjetër. Dhe marrin 1/10 e votave. Duhen 3 000 firma për një parti. Por marrin para për pjesëmarrje në zgjedhje. Ne në Këshillin Politik ku ata nuk erdhën, donim të diskutonim këto gjëra. Subjektet zgjedhore do të përcaktohen në kodin zgjedhor", ka thënë Rama.

Ndërsa opozita e bashkuar jashtë Kuvendit ka thënë është e gatshme ta vazhdojë dialogun për reformën zgjedhore, pa cenuar marrëveshjen e miratuar në Kuvend. "Miratimi i sotëm i marrëveshjes së 5 qershorit pa ndryshime dhe pa ndryshime kushtetuese të njëanshme që e minojnë atë, si dhe vijimi i dialogut politik mes palëve, është rruga e vetme për ta ruajtur konsensusin e arritur, që është mbajtur shënim nga



partnerët dhe shton shanset për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Ky është qëllimi i opozitës së bashkuar, që nga 14 janari, ku jemi angazhuar në mirëbesim në Këshillin Politik. Ky duhet të jetë qëllimi i përbashkët i të gjitha partive politike në Shqipëri, si e vetmja mënyrë për garantimin e një klime normale politike para zgjedhjeve dhe për ecjen përpara të Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian", është thënë në deklaratën e opozitës së bashkuar, duke shprehur mirënjohjen ndaj ShBA-së dhe vendeve anëtare të BE-së, Britanisë së Madhe dhe OSBE-së për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar për arritjen e një reforme zgjedhore konsensuale.

Miratimin e kësaj marrëveshje e kanë mirëpritur ShBA-ja dhe BE-ja. Ambasadorja e ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim, ka thënë se kjo marrëveshje tashmë është ligj. "Marrëveshja e 5 qershorit është tani ligj. Përfshirja dhe transparenca duhet të jenë norma për veprime të rëndësishme kombëtare", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Twitter". Kurse ambasadori i BE-së në Tiranë, Luigi Soreca, ka thënë se e mirëpresin marrëveshjen e miratuar në Kuvend në lidhje me reformën zgjedhore. "Kjo përmbush një nga kushtet kryesore për t'i filluar negociatat e pranimit të Bashkimit Evropian, siç thuhet në konkluzionet e Këshillit të 25. 03. 2020. Dispozitat e reja legjislative do t'i japin Shqipërisë një kornizë zgjedhore me integritet dhe standarde më të larta transparence, bazuar në rekomandimet e OSBE/ODHIR. Ne kemi marrë parasysh propozimet shtesë për reformimin e sistemit zgjedhor. Ndërsa pranuam rolin e Parlamentit në paraqitjen e ndryshimeve shtesë në lidhje me sistemin zgjedhor, ne nxisim të gjitha palët t'i vazhdojnë diskutimet në Këshillin Politik me të njëjtën frymë gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese demonstruar gjatë miratimit të marrëveshjes politike të 5 qershorit. Procesi që çon në ndryshime shtesë nuk duhet ta dëmtojë frymën dhe rezultatet e marrëveshjes së 5 qershorit", është thënë në deklaratën e ambasadorit të BE-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Osmani sërish përplaset me deputetët e LDK-së

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, edhe të enjten është përplasur në Kuvend me deputetët e LDK-së. Nënkryetari i Kuvendit nga radhët e LDK-së, Kujtim Shala, dhe shefi i deputetëve ië LDK-së, Arben Gashi, i kanë kërkuar Osmanit të mos ndërhyjë në fjalët e ministrave dhe të deputetëve. Ndërsa Osmani u është përgjigjur atyre, duke thënë se nuk janë mësuar me kryetar të Kuvendit i cili respekton Rregulloren e Kuvendit



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani dhe nënkryetari i Kuvendit nga radhët e LDK-së, Kujtim Shala, janë përplasur sërish të enjten në Kuvend. Këtë herë polemika ka pasur të bëjë me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Debati është nxitur pas ndërhyrjes që kryeparlamentarja Osmani ka bërë në fjalën e ministres së Punëve Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ministrave dhe disa deputetëve. Shala i ka thënë Osmanit se nuk mund të ndërhyjë dhe të bëjë komente të fjalimeve që bëhen në Kuvend. "Provat që ju mundoheni t'i paraqisni kundër qeverisë janë të mjaftueshme. Por, ju s'mund të bëni komente politike, sepse nuk e lejon procedura", ka thënë Shala.

Ndërsa Osmani ka qenë shumë e ashpër duke i thënë Shalës se s'jeni mësuar me kryetar të Kuvendit që respekton Rregulloren e Kuvendit. "Ju jeni mësuar me kryetarë të Kuvendit që i keni quajtur pjesë të bandave dhe tashmë s'mund të duroni një kryetare që respekton rregulloren. Ju duhet të mësoheni sepse, siç thonë amerikanët, 'There is a new Sherif in town (Është një sherif i ri në qytet). Duhet ta harroni që unë drejtoj seanca vetëm në mënyrë teknike", ka thënë ajo.

Në këtë debat është përfshirë edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Abren Gashi. Ai ka thënë se kryesuesi i seancës duhet t'i përmbahet rregullores dhe të marrë fjalën si deputete, por jo t'ia ndalojë ministres fjalën dhe të japë komente. "Të mos komentohet, të mos shkohet më tej. Jo komentim të qëndrimeve të ministres apo dikujt tjetër. Jo ndërhyrje në fjalë dhe procedurë. Të jemi të qartë, askush nuk ta tejkalojë rregulloren", ka deklaruar Gashi.

I menjëhershëm ka qenë reagimi i Osmanit, e cila me tone të ashpra, duke kërkuar të mos e ngrehin zërin deputetët e partisë së saj, ka thënë se ajo e njeh rregulloren dhe ka replikuar ministren, por që ajo nuk ka folur më. "E para, nuk ka asnjë dispozitë në Rregulloren e Kuvendit që kryetares së Kuvendit t'ia ndalë fjalën si deputete dhe e shfrytëzova të drejtën time mbi Rregulloren. Kjo ishte kundër-replikë. Mos e ngrit zërin", ka deklaruar Osmani.

Në këtë debat janë përfshirë edhe partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës, të cilat janë deklaruar se e mbështesin udhëheqjen e seancave të Kuvendit të Kosovës nga Vjosa Osmani.

Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, ka thënë se Osmani e udhëheq Kuvendin në mënyrën më të mirë të mundshme. "E kuptoj shqetësimin e deputetëve, por nuk e kuptoj egërsinë e tyre ndaj kryetares së Kuvendit. Ju po e udhëhiqni shumë mirë seancën, ndërsa i bëj thirrje zotëri Hotit, ta ketë parasysh, të flasë me kabinetin e vet qeveritar. Unë ju them ta mbani kështu në vijë seancën, pavarësisht këtyre klithjeve që vijnë herë pas here dhe të vazhdoni ta drejtoni siç po e drejtoni sepse po e drejtoni shumë mirë", ka thënë Selimi.

Ndërsa nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se edhe për subjektin e tyre Osmani i menaxhon seancat mirë. "Nuk mendoj se po dilni jashtë prej asaj çka përcakton Rregullorja e Kuvendit. Secili kryetar edhe në të kaluarën e ka pasur një mënyrë për menaxhimin e temave", ka thënë Memli.

## Osmani keqkuptohet edhe me Zemajn

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, teksa ka polemizuar me deputetët e LDK-së, Kujtim Shala e Arben Gashi, e ka akuzuar ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, se po e fyen atë duke i thënë "mos rrej". Më pas, ministri Zemaj e ka kërkuar fjalën për t'u sqaruar, duke i mohuar pretendimet e kryeparlamentares. "Kryetare, të kisha lutur që, si e para e Kuvendit, është pak mirë që debatin ta drejtoni në relaksim të situatës. Nuk ju thashë mos na rrej, por mos na rreh", ka thënë Zemaj.

# Në Kuvendin e Kosovës u inaugurua 'Këndi i kurajës'

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Në zbatim të Rezolutës për krijimin e "Këndit të kurajës", të votuar në Kuvendin e Kosovës, të enjten në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës është inauguruar ky kënd, i cili është iniciuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi. Në këtë kënd janë ekspozuar punimet e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së vitit 1999, mundësuar nga Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës, Medica Kosova dhe Medica Gjakova.



Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se nëpërmjet këtij projekti po shihet forca e grave dhe vajzave që mbijetuan luftën, por edhe dhunën seksuale gjatë asaj lufte. "Sot këtë forcë e shohim të shndërruar në art dhe në kreativitet përmes punës së dorës. Nga dita e parë e ardhjes sime në krye të Kuvendit, jam zotuar së bashku me koleget deputete se do ta mbështesim çdo nismë që ka të bëjë me promovimin dhe avancimin e të drejtave të grave, sepse besojmë fuqishëm se fuqizimi i grave është gurthemeli më i fuqishëm dhe më i qëndrueshëm për demokracinë e vendit tonë", ka thënë Osmani. Ajo ka shfaqur besimin se kjo nismë të vazhdojë të zbatohet edhe në institucione të tjera, ashtu siç është paraparë në rezolutën e votuar në Kuvend, në veçanti në Qeveri dhe Presidencë, e pastaj edhe në komuna e institucione.

Më tutje, ajo ka premtuar se do të jenë çdoherë në mbështetje të tyre, duke paralajmëruar se dhuratat që ekspozohen në "Këndin e kurajës" do të jepen në emër të Kuvendit të Kosovës në çdo vizitë jashtë vendit dhe në çdo takim me miq ndërkombëtarë.

Kurse Feride Rushiti nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës ka thënë se ndihet e emocionuar që po jetësohet kjo iniciativë. Ajo ka thënë se ky vend do të jetë inkurajues për gratë që sot e 20 vjet nuk po e gëzojnë tërësisht lirinë. Në anën tjetër, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, me iniciativën e së cilës është krijuar ky kënd, ka theksuar se institucionet publike, e veçanërisht Kuvendi, duhet të jetë vendi ku kujtohet e kaluara, kujtohen të gjitha ato gra dhe burra që mundësuan lirinë, por kujtohen edhe të gjitha ato krime të pandëshkuara të cilat vazhdojnë të mbesin plagë të hapura.

Nisin diskutimet politike në nivel ekspertësh në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel

# S’ka marrëveshje të veçanta pa



Kosova dhe Serbia kanë nisur të enjten diskutimet politike në nivel ekspertësh, në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve në Bruksel. Takimi i parë në mes të dy delegacioneve është konsideruar konstruktiv, por nuk janë dhënë detaje se çka është biseduar. Pas këtij takimi, koordinatori shtetëror Skender Hyseni ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje të veçanta me Serbinë përderisa nuk ka marrëveshje gjithëpërfshirëse. Hyseni ka bërë me dije se do të marrin një periudhë kohore për t’i trajtuar elementet e veçanta, ose kapitujt e një marrëveshje gjithëpërfshirëse

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë në nivel ekspertësh ka nisur bisedimet të enjten. Pas takimit të parë, koordinatori shtetëror Skender Hyseni ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje të veçanta përderisa nuk ka marrëveshje gjithëpërfshirëse. Takimin e parë të këtij niveli me drejtorin e së ashtuquajturës Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, Hyseni e ka quajtur konstruktiv, duke thënë se ka pajtim rreth elementeve të caktuara. “Unë thashë që diskutimi ka qenë konstruktiv. Nëse flasim për element specifik të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, do të na mirëkuptoni nëse nuk jap detaje sepse nuk do të ketë marrëveshje separate për asnjë temë përderisa nuk do të ketë marrëveshje gjithëpërfshirëse”, ka thënë ai.

Hyseni ka vlerësuar se do të marrin një periudhë kohore për t’i trajtuar elementet e veçanta, ose kapitujt e një marrëveshje gjithëpërfshirëse. “Nuk ka marrëveshje për kapituj të veçantë përderisa nuk do të ketë marrëveshje gjithëpërfshirëse. Nëse flasim për një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërisht të obligueshme, atëherë ne flasim për element të caktuar të një marrëveshje. Elementet e caktuara nuk janë kapituj takstativë, por janë kapituj të një marrëveshje të përgjithshme, ndërkaq çdo tjetër mbetet subjekt i një marrëveshje gjithëpërfshirëse”, ka thënë ai.

Hyseni ka mohuar se ky proces me Serbinë është teknik. “Nuk ka më asgjë teknike, është skajshmërisht politik. Dhe, një ditë kur elementet e marrëveshjes gjithëpërfshirëse të pajtohen në tërësi, do të shihen që janë elementë të një marrëveshjeje, së cilës i subordinohet çdo gjë tjetër. Prandaj, nuk mund ta zvarritin procesin tash e tutje, duke trajtuar tema të ndara të cilat mund të zbatohen dhe mund të mos zbatohen dhe që varen nga vullneti i mirë dhe i lirë i cilësdo palë. Tash po flasim për një marrëveshje ndërkombëtare ligjërisht të obligueshme, të cilën do të detyrohen të dyja palët që ta zbatojnë në terren, sepse do ta ketë vulën ndërkombëtare”, ka thënë Hyseni.

Para fillimit të këtij takimi edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se dialogu teknik me Serbinë ka përfunduar. “Dialogu nuk ka alternativë, por dialogu teknik ka përfunduar. Tani Kosova ka nisur dialogun për njohje reciproke dhe sot në Bruksel fillon draftimi i kësaj marrëveshje. Qasja refuzuese ndaj dialogut dhe ndaj miqve tanë në të kaluarën e afërt na ka izoluar. Shtëpia nuk mbahet pa miq”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”.

Ai ka deklaruar se institucionet e Kosovës janë duke e ushtruar autoritetin e vet në këtë drejtim. “Kosova ka një kryeminister që po i ushtron autorizimet kushtetuese pa lejuar asnjë ndërhyrje në ato autorizime, por duke e koordinuar agjendën

## Ambasada e ShBA-së në Kosovë: Politika të qëndrojë larg zgjedhjeve në UP

Prishtinë, 23 korrik (ER) - Ambasada e Shteteve të Bashkuara e Amerikës (ShBA) në Kosovë ka bërë thirrje që politika të qëndrojë larg nga zgjedhjet e ardhshme në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në llogarinë zyrtare të vet në “Twitter”, kjo ambasadë ka shkruar se lidershipi i këtij universiteti duhet të zgjedhet në bazë të meritave profesionale dhe akademike. “Zgjedhjet e ardhshme të Universitetit të Prishtinës duhet të mbesin të lira nga politika. Ky lidership jetik i institucionit duhet të zgjidhet në bazë të meritave profesionale dhe akademike”, është thënë në reagimin e Ambasadës Amerikane. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është në proces të brendshëm zgjedhor, ku së shpejti pritet të zgjedhet rektori i ri i këtij universiteti.



# marrëveshje gjithëpërfshirëse



e shtetërore të Kosovës me bartësit e institucioneve, me partnerët e koalicionit dhe me opozitën, si dhe duke e mbajtur plotësisht të informuar publikun e gjerë", ka shkruar Hoti.

I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, paraprakisht ka zhvilluar takime të ndara me dy negociatorët, Skender Hysenin nga Kosova dhe Marko Gjuriqin nga Serbia. Lajçaku është shprehur i kënaqur me këto takime. "Sot ne i vazhdojmë diskutimet tona politike në nivel ekspertësh. I kënaqur që pres negociatorët e të dyja palëve, Skender Hysenin dhe Marko Gjuriqin, këtë mëngjes", ka shkruar Lajçak në "Twitter".

Ky është takimi i parë në nivel ekspertësh që nga rifillimi i dialogut politik që u mbajt më 16 korrik midis kryeministrit Avdullah Hotit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

### Rinisja e dialogut në nivel ekspertësh nuk mirëpritët në Prishtinë

Përveç partive opozitare, Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës, ai u kundërshtua edhe nga partnerët e koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate, por edhe nga Presidenca, kanë thënë se procesi i tillë zvarrit arritjen e marrëveshjes finale.

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar prishjen e koalicionit për shkak të këtij procesi. "Ia kam thënë zyrtarisht, i kam dërguar edhe shkresë ku i kemi vërejtjet. Nuk ka pasur arsye me marrë shefen e kabinetit të tij përballë takimit me Aleksandër Vuçiqin që tash e ka përvojën e parë e me lënë jashtë takimit Selim Selimin", ka thënë Haradinaj.

Edhe partneri tjetër i koalicionit, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se nuk e mbështet dialogun teknik. "Pa njohje s'ka implementim të marrëveshjeve. Koha ka ardhur në një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila e ka njohjen brenda dhe organizimin në OKB. Ky është qëndrimi që duhet ta mbrojë kryeministri Hoti. Dialog për njohje me afat kohor. Kosova është e interesuar me këto parime. Dialogu të ketë emër. Dialog për njohje. Ky dialog e mbështetë Nisma", ka thënë Limaj.

# 42 për qind e qytetarëve të Serbisë e konsiderojnë Kosovën "të humbur"

Prishtinë, 23 korrik - Rezultatet e hulumtimit të Institutit për Çështje Evropiane, organizatë kjo joqeveritare, tregojnë se numri i qytetarëve të Serbisë që do të votonin kundër pavarësisë së Kosovës, në krahasim me vitin e kaluar, është duke rënë për arsye se shumica e tyre konsiderojnë që Serbia nuk mund sërish të ketë kontroll të plotë mbi Kosovën, ndërkohë që shumica dërrmuese nuk e di se cili është plani i Qeverisë së Serbisë për Kosovën.

Hulumtimi i opinionit publik lidhur me marrëdhëniet e qytetarëve të Serbisë ndaj Kosovës është bërë gjatë periudhës nga 6 deri më 12 mars 2020, në një mostër përfaqësuese prej 1 203 të anketuarve, në bashkëpunim me shtëpinë hulumtuese "Ninamedia".

Gati se gjysma e të anketuarve (46 për qind) konsideron se nuk është e mundur që Serbia sërish ta realizojë kontrollin dhe sovranitetin e plotë mbi Kosovën, ndërkaq 38 për qind e të anketuarve konsiderojnë se një gjë e tillë është e mundur. Se kjo është e mundur në masë më të madhe, këtë e konsiderojnë të anketuarit me moshë më të vjetër se 45 vjet dhe të anketuarit me nivel më të ulët të arsimimit, është thënë në hulumtim, shkruan "Rel"-i.

Se Kosova është e humbur, këtë e konsiderojnë 42 për qind e qytetarëve, ndërkaq 46 për qind konsiderojnë se nuk është e humbur. Qëndrimi se Kosova është e humbur, në masë më të madhe është shprehur nga të anketuarit e moshës 30 deri 44 vjeç, nga të anketuarit me nivelin më të lartë të arsimimit dhe nga popullata e qyteteve, tregojnë rezultatet e hulumtimit.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 77 për qind e tyre nuk do ta mbështesnin pavarësinë e Kosovës në këmbim të anëtarësimit më të shpejtë të Serbisë në Bashkimin Evropian, ndërkaq 13 për qind e të anketuarve do ta mbështesnin. Të anketuarit mbi moshën 45 vjet janë ata që janë në numër më të madh që kanë qëndrimin se nuk do të duhej të pranohej pavarësia e Kosovës.

### Shumica nuk e di se cili është plani për Kosovën

89 për qind e të anketuarve nuk e dinë se cili është plani i Qeverisë së Serbisë për Kosovën. "Planin e presidentit Aleksandër Vuçiq, i cili Kosovës do t'ia sillte pavarësinë, kurse qytetarëve të Serbisë një shtet të qëndrueshëm dhe standard më të mirë, nuk do ta përkrahnin 57 për qind e të anketuarve, ndërkaq 23 për qind do ta përkrahnin këtë plan", është thënë në hulumtim.

Pak më shumë se një e katërta (27 për qind) e të anketuarve konsideron se kjo qeveri (e Serbisë) do ta pranojë Kosovën, ndërkaq pak më shumë se gjysma e të anketuarve (53 për qind) mendon se kjo qeveri nuk do ta bëjë këtë. Një e pesta e të anketuarve nuk di se si të deklarohet. Në qoftë se nesër do të kishte një referendum për pavarësinë e Kosovës, shumica e të anketuarve do të votonin kundër (66 për qind), në votim nuk do të dilnin 14 për qind, 11 për qind nuk do të dinin se si të votonin, ndërkaq 9 për qind do të votonin për. Të anketuarit që do të votonin kundër, në masën më të madhe janë meshkuj dhe të anketuarit mbi moshën 45 vjet.

Në raport me vitin 2019, është vërejtur ulje e numrit të të anketuarve që do të votonin kundër pavarësisë së Kosovës, ka theksuar Instituti për Çështje Evropiane.

Instituti për Çështje Evropiane është organizatë e pavarur joqeveritare, i cili në Serbi është themeluar në vitin 2010. Ky institut i përcjellë bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Bashkimit Evropian dhe angazhohet në mënyrë aktive për anëtarësimin e Serbisë në kornizat euroatlantike.



## Thaçi informohet nga Tërnava për nisjen e ndërtimit të Xhamisë së Madhe

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim myftiun Naim Tërnava, i cili e ka informuar për nisjen e ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Me këtë rast, Thaçi ka thënë se harmonia ndërfetare është vlera më e madhe e popullit të Kosovës. "Vlera më e madhe e popullit tonë është respekti i ndërsjellë mes besimeve dhe harmonia ndërfetare. Ne duhet t'i promovojmë këto vlera dhe pasuri të Kosovës. Myftiu Tërnava më informoi për nisjen e ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Kosova është atdhe i të gjithëve", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Të enjten presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Hasan Prishtina". Ai ka bërë me dije se me ta ka biseduar për të ardhmen, historinë, drejtësinë, mirëqenien dhe fqinjësinë e mirë. "Në ajrin e pastër të Kosovës, sot kalova kohë me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit 'Hasan Prishtina'. Biseduam për të ardhmen, historinë, drejtësinë, mirëqenien dhe fqinjësinë e mirë", ka shkruar Thaçi.



# Christian Heldt përfundon mandatin e ambasadorit të Gjermanisë në Kosovë

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Christian Heldt, sot (e premte) do të largohet nga Kosova, duke përfunduar kështu mandatin trevjeçar në krye të Ambasadës së Gjermanisë. Diplomati gjerman është shprehur i mërzitur që i duhet të largohet nga Kosova pa pasur mundësinë që të përshëndetet me të gjithë miqtë e tij si pasojë e pandemisë dhe Covid-19. Por, Heldt ka thënë se do të kthehet privatisht e si mik, për t'i takuar të gjithë miqtë e tij në Kosovë dhe për t'i bërë të gjitha gjërat që s'ka mundur t'i bëjë si pasojë e pandemisë. "Në gjermanisht është një shprehje që thotë 'ende e kam një valixhe në Berlin', kuptimi i së cilës është që ke lënë diçka pas tek e cila do të kthehesh sërish. E pra, unë po e lë në Kosovë një pjesë të madhe të valixhes sime", ka thënë Heldt në një video të publikuar në llogarinë e vet në "Twitter".



Me rastin e përfundimit të mandatit në krye të Ambasadës së Gjermanisë, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të enjten në një takim lamtumirës ambasadorin Christian Heldt, të cilin e ka falënderuar për bashkëpunimin dhe angazhimin e tij gjatë mandatit në Kosovë. Hoti ka vlerësuar rolin e veçantë të Gjermanisë në procesin e shtetndërtimit demokratik të Kosovës. Hoti ka thënë se qytetarët dhe institucionet e Kosovës janë mirënjohës për ndihmën e përhershme që Gjermania i ka dhënë Kosovës në të gjitha periudhat. Gjatë takimit, Hoti e ka vlerësuar punën e Heldt në Kosovë, duke i uruar atij sukses në detyrat e ardhshme. Ndërsa ambasadori Heldt, pasi e ka falënderuar kryeministrin Hoti për pritjen dhe bashkëpunimin, ka vlerësuar se marrëdhëniet e mira ndërmjet Gjermanisë dhe Kosovës do të thellohen edhe më tej në të mirë të dy popujve dhe vendeve tona mike.

# Selimi: Nga Maqedonia e Veriut kemi kërkuar ekstradimin e grupit të Kumanovës

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Gazmend Syla, i ka parashtruar një pyetje parlamentare ministrit të Drejtësisë, Selim Selimi, lidhur me të akuzuarit e grupit të Kumanovës që janë nga Kosova. Syla e ka pyetur Selimin nëse po shikohet mundësia që në marrëveshje me Maqedoninë e Veriut shtetasit e Kosovës të sillen në Kosovë. Me këtë rast, Selimi ka thënë se ka vendosur kontakte me homologen nga Maqedonia e Veriut, Renata Destovska, me të cilën ka diskutuar për situatën e këtyre shtetasve të Kosovës. "Me të marrë detyrën si ministër i Drejtësisë kam vendosur kontakte me ministren e Drejtësisë, zonjën Renata Destovksa, kemi diskutuar edhe për shqiptarët e Kosovës që ndodhen në shërbimet korrekutuese të Maqedonisë së Veriut. Sa kemi informacione, kjo çështje është në procedurë të ankimimit", ka thënë Selimi.

I pari i Drejtësisë në Kosovë ka theksuar se ministres maqedonase i ka shprehur vullnetin që Kosova të lidhë marrëveshje ekstradimi për kosovarët me shtetin maqedonas. "I kam thënë që shteti i Kosovës është i gatshëm të lidhë marrëveshje ekstradimi me shtetin maqedonas kurdo që kjo çështje të marr epilog. Pra, marrëveshja e ekstradimit mund të ndodhë kur rasti të marrë epilog përfundimtar. Kemi marrë garanci se drejtësia nuk do të jetë diskriminuese", është shprehur Selimi.



# Osmani, Apostolovës: Kosova qëndron e palëkundur në rrugën eurointegruese



Prishtinë, 23 korrik (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim lamtumirës shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Nataliya Apostolova, me rastin e përfundimit të misionit të saj diplomatik në vendin tonë. Osmani e ka uruar Apostolovën për punën e shkëlqyer si përfaqësuese e Bashkimit Evropian në Kosovë si dhe për koordinimin efektiv ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe BE-së.

Më tutje, kryeparlamentarja Osmani ka thënë se Republika e Kosovës qëndron e palëkundur në aspiratën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Sipas saj, gjatë misionit diplomatik të Apostolovës, prania e BE-së është ndier pothuajse në të gjitha fushat dhe asistenca nga BE-ja ka ndihmuar në adresimin e problematikave të ndryshme me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës në baza të përditshme. Në mesin e tyre, kryetarja ka vlerësuar në veçanti edhe angazhimin aktiv të Apostolovës për fuqizimin e grave dhe avancimin e të drejtave të tyre. Në fund, Osmani i ka uruar Apostolovës suksese në angazhimin e mëtejmë dhe e ka siguruar atë që institucionet e Kosovës do të jenë mikpritëse ndaj shefes së re të Zyrës së BE-së në Kosovë për ta vazhduar bashkëpunimin me BE-në.

136 TË SHËRUAR DHE 181 RASTE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË

# Krasniqi infektohet me Covid-19, Veseli izolohet, Mustafa shërohet

Përhapja e koronavirusit në Kosovë nuk po kursen as politikanët. Kohën e fundit nga Covid-19 janë infektuar disa deputetë të partive politike. Të enjten ish-kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Fitim Uka, kanë rezultatet e bëra për koronavirus u kanë dalë pozitive, kurse lideri PDK-së, Kadri Veseli, ka bërë me dije se, pas disa simptomave, është vetizoluar dhe është në pritje të rezultatit të testit. Kurse lideri i LDK-së, Isa Mustafa, i cili kishte dalë pozitiv me Covid-19, jozyrtarisht është mësuar se është shëruar








EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Koronavirusi nuk po kursen as politikanët në Kosovë. Vetëm të enjten disa politikanë të njohur në vend kanë konfirmuar se kanë dalë pozitivë në testin për Covid-19, e disa të tjerë janë në pritje të rezultateve.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate e ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ka treguar se në fillim të javës ka rezultuar i infektuar me Covid-19 dhe ka bërë me dije se deri tani është duke e përballuar mirë këtë virus.

Edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka treguar të enjten se ka bërë testin për Covid-19, pasi i janë paraqitur disa simptoma të lehta. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se në përputhje me rekomandimet e institucioneve shëndetësore është vetizoluar dhe po pret rezultatin e testit. "Pas disa simptomave të lehta dhe dyshimeve që potencialisht mund të jam infektuar me Sars-CoV-2, sot e kam bërë testin. Në përputhje me rekomandimet e institucioneve, jam vetizoluar deri në konfirmimin e rezultatit. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë masat, t'i vendosin maskat dhe ta mbajnë distancën dhe higjienën!", ka shkruar Veseli.

Kurse deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Fitim Uka, ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se që nga e diela, kur i janë shfaqur simptoma të Covid-19, është izoluar, ndërsa sot ka marrë rezultatin e testit. "Që nga e diela më janë shfaqur simptoma të Covid-19. Me rekomandim të mjekut jam izoluar dhe kam respektuar këshillat me përpikëri. Pak më herët kam pranuar telefonatën nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, për të më konfirmuar se rezultati i testit tim për Covid-19 është pozitiv. Sikurse unë, edhe Yllka ka simptomat e njëjta. Ndërkaq, në këtë periudhë izolimi për ne po kujdeset Bindi, me dashuri e 'këshilla profesionale'", ka shkruar Uka. Ai ka thënë se gënjen kushdo që thotë se është lehtë të ballafaqoni Covid-19, duke i ftuar qytetarët t'i ndjekin rekomandimet e IKShPK-së.

Para 10 dite lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka treguar se është infektuar me virus, kurse të enjten jozyrtarisht është mësuar se ai është shëruar nga ky infektim. Për shkak të shtimit të numrit të deputetëve të prekur me koronavirus, Lidhja Demokratike e Kosovës ditë me parë ka propozuar në Kuvend ndryshimin e Rregullores së Kuvendit, e cila ua mundëson deputetëve mbajtjen e seancave nga largësia.

## Tetë të vdekur brenda 24 orëve

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit janë shëruar 136 persona të infektuar me Covid-19 dhe janë paraqitur 181 raste të reja. Gjithashtu, sipas IKShPK-së, brenda 24 orëve në Kosovë kanë ndërruar jetë tetë persona të prekur nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 420 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 181 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 6 467 raste nga 32 795 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 158 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 136 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3 505 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 804", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 77 raste, komuna Gjilan 17 raste, komuna komuna Pejë 13 raste, Mitrovicë 10 raste, komuna Vushtrri 10 raste, komuna Viti 8 raste, komuna Drenas 6 raste, komuna Fushë Kosovë 6 raste, komuna Lipjan 6 raste, komuna Podujevë 6 raste, komuna Dragash 4 raste, komuna Deçan 3 raste kurse nga 2 raste komunat: Ferizaj, Malishevë Obiliq, Prizren, Skenderaj, Suharekë dhe nga 1 rast Istog, Kaçanik dhe Kamenicë.

## UNDP-ja i dorëzoi IKShPK-së 41 mijë komplete testimi për Covid-19

UNDP-ja ia ka dorëzuar IKShPK-së 41 000 komplete testimi për COVID-19, të financuara nga Qeveria e Luksemburgut dhe e Austrisë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka marrë pjesë në dorëzimin e këtij donacioni, ka shprehur falënderime për këtë kontribut të çmuar. Ai ka thënë se ky donacion do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës për ballafaqim me pandeminë Covid-19. "MSh dhe IKShP janë shumë falënderues për këtë kontribut, i cili lehtëson punën e institucioneve, njëkohësisht krijon mundësi për rritjen e testimeve për diagnostikim të Covid-19", ka thënë Zemaj. Kurse ambasadori austriak Christoph Weidinger ka thënë se është i lumtur që qeveria e vendit të tij dhe partnerët e tjerë po e ndihmojnë popullin e Kosovës në luftimin e pandemisë Covid -19. Kompletet për testim janë blerë me 500 000 euro nga marrëveshja me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes Lux Development S. A dhe marrëveshjes me Qeverinë e Austrisë përmes Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në vlerë të përgjithshme prej 250 000 eurosh.

# Kuvendi ratifikoi pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare

EPOKA E RE A. MAVRAJ



PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas përpjekjeve disajavëshe, të enjten ka arritur t'i ratifikojë pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik. Marrëveshjet të cilat janë ratifikuar nga deputetët janë: ajo për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar, Marrëveshja për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan, Marrëveshja ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Dogana 2020", Marrëveshja ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Fiskalis 2020" dhe Marrëveshja për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Pas ratifikimit të këtyre marrëveshjeve, kryeministri Avdullah Hoti ka falënderuar deputetët e pozitës dhe opozitës për ratifikimin e pesë marrëveshje ndërkombëtare në seancën e sotme. Në llogarinë e vet në "Facebook", Hoti ka shkruar se këto marrëveshje ndihmojnë në zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike. "Falënderoj të gjithë deputetët, të koalicionit qeverisës dhe të opozitës, për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Këto marrëveshje ndihmojnë në zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike. Pres që në ditët në vijim të miratohen edhe rishikimi i buxhetit dhe Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, duke e kompletuar kështu të gjithë bazën ligjore për rimëkëmbjen ekonomike, që është shumë e nevojshme për qytetarë dhe biznese. Qeveria do ta bëjë maksimumin që sa më parë ta nisë zbatimin e masave për rimëkëmbje ekonomike, me transparencë të plotë dhe në koordinimin me të gjithë aktorët e tjerë, komunat, odat ekomomike, partnerët zhvillimorë etj", ka shkruar Hoti.

Edhe zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka përshëndetur ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ai ka thënë se votimi i të gjitha marrveshjeve ndrkombtare është një hap i madh në një koh sfiduese. Votimi i të gjitha marrveshjeve ndrkombtare hap i madh në një koh sfiduese. Marrëveshjet konfirmojnë prkushtimin e Republikës së Kosovs, institucioneve t saj dhe partive politike, q ta thellojmë partneritetin me partnert tanë dhe institucionet strategjike. Marrveshjet premtojnë rezultate dhe efekte n disa drejtime, duke na lejuar nj qartsi n planifikimin e financave, n rifreskimin e potencialit vendor ekonomik, n stabilizimin e efekteve negative t shkaktuara nga kriza pandemike, n mbarvajtjen e projekteve dhe realizimin e tyre efikas, sigurimin e potencialit m t madh financues, prfshir edhe ndikimin pozitiv tek operatort financiar, ekonomik, si dhe n rrafshin social. Ky duhet t jet modeli i bashkveprimit politik, modeli i s ardhms!", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Gjithashtu, shefja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka mirëpritur ratifikimin nga Kuvendi i Kosovës të pesë marrëveshjeve ndërkombëtare. Ajo ka deklaruar se ratifikimi i këtyre marrëveshjeve ia mundëson pjesëmarrjen Kosovës në programet e BE-së. "E mirëpres ratifikimin e ditës së sotme të marrëveshjeve në Kuvendin e Kosovës të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së Fiskalizimi 2020 dhe Doganat 2020. Pjesëmarrja në këto programe do t'i lejojë administratës tatimore dhe doganore të Kosovës t'i përmirësojë dhe t'i modernizojë funksionet e tyre, ta forcojë bashkëpunimin dhe të shkëmbejë ekspertiza me autoritetet e shteteve anëtare të BE-së dhe përtej", ka thënë Apostolova.

# OEK-u mirëpret votimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike Covid-19

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka thënë se e mirëpret miratimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike Covid-19, të cilin qeveria Hoti e ka përcjellë për trajtim në Kuvend. Sipas OEK-ut, i njëjti projektligj duhet të miratohet edhe nga deputetët e Kuvendit të Kosovës në mënyrë që t'i hapet rruga zbatimit të masave konkrete për rimëkëmbjen ekonomike.




"Komuniteti i biznesit kërkon veprime të shpejta të Kuvendit për miratimin e këtij ligji, miratimin e rishikimit të buxhetit në lexim të dytë, si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, për t'i krijuar kushtet e plota ligjore dhe financiare për zbatimin e masave për rimëkëmbjen ekonomike. Rimëkëmbja ekonomike është proces i gjatë dhe kërkon bashkëpunim të të gjithë aktorëve për të harmonizuar një numër të madh të vendimeve dhe veprimeve, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare me efekt financiar, rritjen e borxhit publik, krijimin e mundësive të reja për eksportin e produkteve të Kosovës, avancimin e bashkëpunimit rajonal, investimet në infrastrukturë etj", është thënë në njoftimin e OEK-ut.

Më tutje, OEK-u ka theksuar se masat konkrete të rimëkëmbjes ekonomike duhet të jenë efikase dhe të orientuara për përkrahjen e sektorëve më të goditur nga pandemia Covid-19 dhe, para së gjithash, prioritet janë masat që garantojnë qasje të favorshme në financa, masat që ndikojnë në rritje të kërkesës agregate dhe masat që ndikojnë në rritje të eksportit.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 15-të ka miratuar Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19.

# Letrat me vlerë, më 30 korrik mbahet ankandi i nëntë me radhë për vitin 2020

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Ministria e Financave njofton se më 30 korrik 2020 do të mbahet ankandi i nëntë me radhë për vitin 2020 në lidhje me letrat me vlerë. Në këtë ankand do të bëhet rihapja e obligacionit 10-vjeçar të emetuar paraprakisht më 31 korrik 2018. Vlera e emetuar do të jetë 10 milionë euro me frekuencë të pagesës së interesit çdo 6 muaj. "Investimi në obligacione është investim i sigurt i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit të kontaktojnë ndonjërën nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin e Ministrisë e Ministrisë së Financave.



# OEAK-u bën thirrje që politika të fokusohet në shmangien e kolapsit të sektorit privat

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) edhe një herë u ka barë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta aprovojnë pa vonesë buxhetin e rishikuar për vitin 2020, i cili, sipas këtij kodi, do ta mundësonte vazhdimin e zbatimit të masave në përkrahje të sektorit privat. "Oda Amerikane beson se përkrahja për sektorin privat dhe rimëkëmbjen ekonomike duhet të zënë vend në diskursin e përditshëm politik në vend të temave boshe të cilat nuk ofrojnë ndonjë zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohet Kosova", ka njoftuar OEAK-u

EPOKA E RE A. MAVRAJ

**Prishtinë, 23 korrik** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka theksuar se situata e jashtëzakonshme nëpër të cilën është duke kaluar ekonomia e vendit kërkon qasje dhe veprime të jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, kjo odë ka thënë se janë për keqardhje dhe të papranueshme veprimet e ngadalshme të institucioneve të Kosovës në ofrimin e përkrahjes për sektorin privat, pas shpërthimit të pandemisë Covid-19, në kohën kur ndërmarrjet e këtij sektori ndodhen para një kolapsi. "Oda Amerikane beson se përkrahja për sektorin privat dhe rimëkëmbjen ekonomike duhet të zënë vend në diskursin e përditshëm politik në vend të temave boshe të cilat, përveç se nuk ofrojnë ndonjë zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohet Kosova, thellojnë përçarjen politike tash kur dialogu konstruktiv dhe veprimet e shpejta janë të domosdoshme dhe nuk kanë alternativë. Oda Amerikane thërret edhe një herë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të aprovojnë pa vonesë buxhetin e rishikuar për vitin 2020 i cili do ta mundësonte vazhdimin e zbatimit të masave në përkrahje të sektorit privat, si dhe të aprovojnë me procedurë të shpejtë edhe Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili do ta çelte rrugën për zbatimin e masave të rimëkëmbjes, e me këtë edhe marrëveshjet financiare ndërkombëtare, si burime të rëndësishme për zbatimin e masave të sipërcekura", është thënë në njoftimin e OEAK-ut, duke shtuar se çdo zvarritje e marrjes së masave nga ana e institucioneve nënkupton goditje të papërballueshme për bizneset. "Çfarëdo zvarritje e paarsyeshme që do ta vononte përkrahjen për ndërmarrjet e sektorit privat do t'i jepte goditje të papërballueshme këtij të fundit, ndërsa do t'i bënte bashkëfajtore partitë politike, në procesin e kolapsit të sektorit privat, mbylljes së vendeve të punës dhe përkeqësimit të gjendjes sociale", ka njoftuar kjo odë.

Në fund, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka ripërsëritur se, përveç veprimeve që lidhen me rimëkëmbjen ekonomike, Qeveria dhe Kuvendi duhet të demonstrojnë një qasje më dinamike edhe në aspektin e agjendës legjislative, duke përshpejtuar hartimin dhe aprovimin e ligjeve të cilat do ta përmirësonin mjedisin e të bërit biznes si dhe ofertën e vendit para investitorëve të huaj.

# Protestojnë punëtorët e Telekomit, kërkojnë zgjidhje për gjendjen e krijuar në këtë ndërmarrje

Punëtorët e Telekomit të Kosovës kanë protestuar të enjten para Kuvendit të Kosovës dhe njëzëri kanë kërkuar nga partitë parlamentare të jenë unike për zgjidhjen e bllokadës në këtë ndërmarrje. Pas kësaj proteste, kryetari i Federatës Sindikale të Pavarur të Telekomit, Lamih Balaj, është takuar me kryeministrin Avdullah Hoti, i cili ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për të gjetur zgjidhje në një afat optimal për Telekomin, xhirollogaritë e të cilit tashmë janë bllokuar. Për Telekomin është zhvilluar të enjten në debat parlamentar, ku deputetët e pozitës e kanë akuzuar njëri-tjetrin për gjendjen në këtë ndërmarrje




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 23 korrik** - Dhjetëra punëtorë të Telekomit të Kosovës kanë protestuar para Kuvendit, ku njëzëri kanë kërkuar nga partitë parlamentare të jenë unike për zgjidhjen e bllokadës në ndërmarrje, pas bllokimit të xhirollogarive si pasojë e humbjes së një kontesti gjyqësor në arbitrazh.

Kryetari i Federatës Sindikale të Pavarur të Telekomit, Lamih Balaj, ka kërkuar nga deputetët dhe Qeveria e Kosovës që t'u ndalin në ndihmë dhe ta shpëtojnë këtë ndërmarrje publike. "Të nderuar deputetë, duhet të bëheni bashkë që ta mbroni Telekomin e Kosovës. Sot u janë mbyllur dyert 3 500 punëtorëve. Sot një person në mënyrë joligjore ka bllokuar të gjitha xhirollogaritë e Telekomit. Ne jemi këtu për ta mbrojtur kompaninë tonë, familjet tona", është shprehur Balaj. Pas kësaj proteste, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur në takim drejtuesit e Sindikatës së Telekomit. Ai i ka siguruar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për të gjetur në një afat optimal dhe një zgjidhje të favorshme për këtë kompani me interes strategjik për ekonominë e vendit. "Hoti kërkoi që Telekomi të vazhdojë t'ua ofrojë shërbimet e veta qytetarëve, ndërkohë që qeveria do ta këtë prioritet stabilizimin dhe rivitalizimin e Telekomit", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Për të dalë nga gjendja e rëndë financiare, Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2019 pati marrë vendim që të privatizohet kjo kompani. Sipas projeksioneve të qeverisë, privatizimi përfshinë pjesën vendimmarrëse të Telekomit, me rreth 51 për qind, duke qëndruar aksionarë për pjesën tjetër. Në Telekomin e Kosovës janë të punësuar mbi 2 600 punëtorë. Për Telekomin është zhvilluar të enjten debat parlamentar, ku deputetët e pozitës e kanë akuzuar njëri-tjetrin për gjendjen në këtë ndërmarrje. Ky debat parlamentar është ftuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

## Deputetët e LV-së: Do t'i përkrahim kërkesat e punëtorëve të Telekomit

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi dhe Hekuran Murati, kanë mbështetur protestën e punëtorëve të Telekomit. Ata u kanë premtuar mbështetje këtyre punëtorëve. Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, para protestuesve ka thënë se ata do të ofrojnë zgjidhje se si do të dilet nga kjo situatë. "Do te jemi përfaqësuesit e juaj në Kuvendin e Kosovës. Ne kemi 31 deputetë dhe do të jemi me ju, siç ishim edhe më herët. Ne jua konfirmojmë mbështetjen edhe në Kuvend, ku qeverisë do t'i japim edhe zgjidhje. Shpresoj se qeveria do t'i dëgjojë kërkesat e juaja", ka thënë Selimi. Ndërsa deputeti tjetër i LV-së, Hekuran Murati, ka thënë se askund nuk ndodh që një kompani të jetë më e fortë se shteti, pos në Kosovë.

# Komuna e Mitrovicës vazhdon dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit komunal

**Mitrovicë, 23 korrik (ER)** - Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka vazhduar mbajtjen e dëgjimeve publike buxhetore, ku ditën e djeshme janë zhvilluar dy takimet e parapara në bazë të orarit të caktuar për planifikimin e buxhetit për vitet 2021-2023 me përfaqësuesit e fshatrave në Bare dhe në Tunel të Parë. Në këto takime ishin të pranishëm drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, zyrtari kryesor financiar Adem Fazliu dhe përfaqësues të këtyre fshatrave.

Fillimisht drejtori Gashi dhe Sadiku i kanë falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në dëgjimet buxhetore dhe kanë shprehur zotimin se të gjitha kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen me kujdes në mënyrë që të futen në zbatim sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore.

Zyrtari kryesor financiar, Adem Fazliu, ka bërë një prezantim të planifikimit të buxhetit, ku ka theksuar se për vitin 2021 buxheti i Komunës së Mitrovicës planifikohet të jetë 21 193 585 euro, e granti i përgjithshëm do të jetë 7 241 010 eurosh, granti specifik për arsim 8 776 311 euro, granti specifik për shëndetësi 2 506 903 euro si dhe financimi për teatrin 169 386 euro.

Të pranishmit kanë pasur mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të kërkesave fillestare dhe të gjithë banorët e pranishëm të fshatrave kanë mbrojtur interesat e vendbanimeve, ku ata jetojnë dhe kanë dhënë sugjerimet e tyre për nevojat emergjente që duhet të planifikohen për vitin e ardhshëm në listën e projekteve kapitale.





# Drenas, prezantohet udhëzuesi për modernizimin e serrave

**Drenas, 23 korrik (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe Arbërije Gllareva, ushtruese e detyrës e drejtoreshës së Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në këtë komunë, kanë pritur në takim këshilltaren e "Crimson Capital Fund", Bernardina Krasniqi. Me këtë rast, Krasniqi ka bërë prezantimin e Udhëzuesit për modernizimin e serrave në Kosovë, i cili është dizajnuar nga Projekti "Përmirësimi i efiçiencës së energjisë dhe burimeve në kultivimin e serrave në Kosovë", financuar nga USAID-i dhe implementuar nga "Crimson Capital Fund". Udhëzuesi ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së fermerëve lidhur me ndikimin e teknologjive të reja në përmirësimin e cilësisë së produkteve, uljes së shpenzimeve dhe rritjes së fitimit nga serrat.

# Fillon rregullimi i oborrit dhe parkingut të Shtëpisë së Kulturës në Malishevë

**Malishevë, 23 korrik (ER)** - Shtëpia e Kulturës "Tahir Sinani" është objekti më i rëndësishëm kulturor në Komunën e Malishevës, ku së shpejti do ta ketë të rregulluar edhe hapësirën e jashtme, përkatësisht oborrin dhe parkingun e saj, pasi të enjten kanë filluar punimet për rregullimin e oborrit. Fillimin e punimeve e ka parë nga afër edhe kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili është njoftuar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, me punimet që do të kryhen në hapësirën e jashtme të shtëpisë së kulturës. Sipas drejtorit Morina, do të rregullohet hapësira e jashtme e oborrit, përfshirë edhe parkingun për vetura. Ai ka thënë se oborri do t'u përshtatet nevojave të Shtëpisë së Kulturës, ndërsa rregullimi i oborrit mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës. Përveç Shtëpisë së Kulturës, në këtë objekt është e vendosur edhe Qendra Rinore.



# Nisin punimet për zgjerimin e rrugës alternative Smirë - Viti

**Viti, 23 korrik (ER)** - Komuna e Vitisë ka bërë me dije se të enjten kanë filluar punimet në zgjerimin e rrugës alternative Smirë - Viti, rrugë kjo që lidhë Smirën me Vitinë, por edhe me fshatrat Drobesh dhe Kabash. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka vizituar këto punime, ku banorët e këtij fshati janë shprehur falënderues për këtë projekt infrastrukturor, duke potencuar se zgjerimi i kësaj rruge e bën atë më lehtë të kalueshme dhe më të sigurt. Ndërsa kryetari Haliti ka potencuar se kjo komunë mbetet e përkushtuar të investojë në të gjitha lokalitetet e saj për të krijuar kushte sa më të mira për të gjithë qytetarët, pa dallime. Gjithashtu, Haliti ka vizituar edhe punimet për ndërtimin e një trotuari në këtë fshat në drejtim të xhamisë.



# USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS KISHTE TIPARET MË TË SPIKATURA TË NJË USHTRIE TË KOHËS SONË (15)



Shkruan: Kudusi LAMA

Dihet që lufta është një gjë e keqe, por ajo është edhe e mirë. Themi e keqe për shkak se në një luftë, sidomos kur kryhet në gjirin dhe në trojet e popullit, pësohen dëme të rënda jo vetëm ekonomike por, në radhë të parë, në forcat njerëzore. Kur je i pushtuar, lufta çlirimtare është edhe e mirë, sepse sjell lirinë, për të cilën edhe varret e të parëve kanë shumë nevojë. Ndërsa për të gjallët, nevoja për liri është kushti i parë për të jetuar. Ajo është si drita, si buka, si uji, si jeta, si dielli dhe si ajri. Kështu duhet kuptuar ndjenja për të kërkuar dhe për ta gjetur lirinë. Pra, rrjedhshëm dalim në përfundimin se vetëm rruga e luftës me serbët ishte rruga e lirisë dhe e pavarësisë së Kosovës.

Kështu pra, Kosova kishte nevojë për mbrojtje. Ia kërkoi mbrojtjen inteligjencies. Ajo ia dha sipas mënyrës së vet, me arsyetime. Ato nuk u morën parasysh. Ia kërkoi popullit të saj, ai doli në protesta, por u rrah e u persekutua në mënyrë më çnjerëzore. Ia kërkoi komunitetit evropian - ai bëri veshin e shurdhër. Ia kërkoi komunitetit botëror - ai dha këshilla. Ç'të bënte Kosova e robëruar? Ajo iu drejtua bijve të saj: “O sot, o kurrë!”, dhe ata rrokën armët për t'i dalë zot. Doli në fushën e betejës Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila u identifikua me rrugën drejt lirisë.

Kur në Kosovë po bëheshin aksionet e para, vetëm ata që ishin ideatorë dhe themelues të kësaj force serioze, e kishin të qartë se cilat do të ishin përmasat e kësaj lufte. Prandaj, me rëndësi ishte që të luftohej se kështu do të arrihej mirëkuptimi me popullin, i cili kishte kuptuar se nuk kishte rrugë tjetër për të arritur në portat e lirisë dhe të pavarësisë.

Vetë shtrirja e Ushtrisë Çlirimtare dhe e veprimtarisë luftarake të saj në tërë territorin e Kosovës, tregoi për mbështetjen e zgjidhjes së çështjes së lirisë nëpërmjet rrugës së luftës, të cilën e zgjodhi djalëria kosovare. Por që brohoritja masive e popullit deri në kupën e qiellit, UÇK, UÇK, UÇK, më 28 nëntor 1997, kur djemtë e UÇK-së deklaruan publikisht UÇK-në para popullit të Kosovës dhe gjithë botës, është treguesi më i qartë se çfarë shihte dhe çfarë priste populli i Kosovës nga djemtë dhe vajzat e tij.

Lufta në Kosovë u organizua dhe u zhvillua sipas një strategjie të studiuar mjaft mirë. Akti i parë i kësaj lufte ishte vendimi dhe praktika e zbatimit të tij, për krijimin dhe fuqizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe asnjë nga ata që kishin rrëmbyer armët nuk ka menduar tjetër veçse të fitohet liria, të çlirohet Kosova ose të jepet jeta në frontet e luftës përballë pushtuesit. Për këtë të vërtetë nuk kam nevojë për dëshmitarë, jam dëshmitar vetë.

Lufta në Kosovë u organizua dhe u realizua sipas një strategjie të studiuar mirë dhe të bazuar në largpamësi. Kjo saktësi strategjike në përcaktimin e rrugës së fillimit dhe të zhvillimit të luftës, bëri që Kosovës t'i falej ushtria në një kohë rekord pas deklarimit në fushat e betejave. Kjo ushtri të cilës iu deshën vetëm 6 muaj aktivitet publik luftarak, te fitoi qytetarinë ndërkombëtare dhe te bëhej një organizëm, i cili tërhoqi vëmendjen e opinionit publik, politik dhe ushtarak të të gjithë botës. Ajo u vlerësua si një nevojë e këtij kombi, në kushtet e robërisë dhe të domosdoshmërisë së fitimit të lirisë së merituar e të nevojshme për çdo popull dhe njeri. UÇK-ja u bë pjesë e jetës së popullit të Kosovës dhe garanci e të ardhmes së saj. Pa këtë ushtri dhe luftën e saj, as që mund të mendohet çlirimi prej pushtimit.

Praktika e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës provoi se ideatorët dhe drejtuesit e kësaj lufte kishin të drejtë. Ata e sollën Kosovën në ditën e lirisë për një kohë rekord dhe me mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. E megjithëse sot po ngrihen akuza kundër tyre, unë i kam parë me armë në krah nëpër fronte dhe e di mirë, se ata as që janë kujtuar se mund të ekzistojë një praktikë e tillë për të cilën po akuzohen sot. Por sot janë të gjithë të zgjuar dhe trima, pasi edhe populli thotë: “Të mençur pas kuvendit e trima pas luftës ka shumë”.

UÇK-ja ishte një ushtri që nuk kishte nevojë t'i bëjnë moral për t'ia mësuar armët, një ushtri që nuk kishte nevojë për ta urdhëruar të shkojë në frontin më të vështirë, një ushtri që nuk kishte në praktikën e saj asnjë thyerje disipline, një ushtri që nuk dyshoi edhe në momentet më të vështira në rrugën e saj të luftës drejt lirisë, nuk mund të konsiderohet ndryshe, veçse ushtri me një moral të pashembullt dhe me ushtarë trima, që dinë mirë çfarë bëjnë dhe pse luftojnë. Kjo ushtri as nuk është kujtuar e as nuk ka pasur kohë të mendojë se si të pasurohet, por ka kërkuar prej popullit shqiptarë që çdo qytetarë të investojë sa të mundet për ta armatosur, për ta veshur e për ta ushqyer.

Morali dhe trimëria janë dy terma, që përfaqësojnë fusha të veçanta të veprimtarisë së individit dhe të familjes, por edhe të shoqërisë. Ata janë bashkudhëtarë në historinë e përcaktimit të tyre si terma, si dhe të njohjes si arsye njerëzore. Ç'është morali? Kësaj pyetjeje i janë dhënë dhe i jepen përgjigje nga më të ndryshmet, por në thelb shprehin të njëjtën gjë. Megjithatë, moralin do ta përcaktojë si një dukuri të ekzistencës së individit, të familjes, të kombit dhe të shoqërisë njerëzore dhe si një tërësi parimesh, normash, kërkesash dhe rregullash, që janë të detyrueshme për secilin në një ambient të caktuar. Morali shpreh forcat e brendshme të një njeriu apo shoqërie, të cilat janë bazë e udhëheqjes për të vepruar për plotësimin e misionit.

Morali i lartë është shfaqja më e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky ishte morali që bëri mrekullinë e madhe të qëndresës për t'i mundur me gjoks tanket dhe topate armikut. Morali i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës arrin lartësi të tillë sa të mos ketë motër në kohën tonë. Ushtari kërkonte vetëm një armë dhe asgjë tjetër. Atë nuk e ndalte asnjë pengesë. Nuk e ndalnin as mungesa e bukës, e ujit, e veshjeve, e zjarrit, e strehës dhe as dendësia e betejave me serbët dhe rreziku i familjeve. Morali ishte gdhendur në ballin e çdo luftëtari: “Liri a vdekje për Atdhe”.

Trimëria është pjellë e moralit të lartë. Të qenit trim shpreh guxim për plotësimin e detyrimeve që e ndjen se i ke. Trimëria është mohim i frikës. Kosova pati dhe ka mjaft mohues të frikës dhe përqafues të trimërisë. Ndërsa sot shumë prej këtyre e ndoshta edhe të gjithë po akuzohen se paskan bërë krime ndaj Serbisë e serbëve. Sa keq që Evropa po i shpërblen në këtë mënyrë luftëtarët e lirisë, që duhet t'i evidenconte si vlera të personalitetit kombëtar modern. Ndërsa konsideron viktima kriminelët të cilët për vrasjet, përdhunimet, masakrat, grabitjet, vjedhjet dhe gjithçka tjetër që kanë bërë në Kosovë, në Beograd kanë marrë secili prej tyre përveç shpërblimeve të mëdha edhe nga 5 (pesë) dekorata mirënjohje në emër të kombit serbë.

Që në fillimet e saj, Lufta Çlirimtare e Kosovës u konsiderua si një organizim terrorist, sepse kështu i interesonte Serbisë dhe kështu propagandonin edhe ata që përkrahnin sundimin serb në Kosovë. Më vjen keq për ata “të ditur” që e quajnë veten edhe ushtarakë edhe politikanë, (kombësia e të cilëve nuk më intereson), të cilët edhe pse kanë bërë shkollë dhe konsiderojnë se e njohin terminologjinë gjuhësore, por që nuk dinë të zbërthejnë termin “terrorizëm”. Më vonë u vunë edhe emra të tjerë si: “forca irredentiste”; “nacionalizëm mesjetar”, “luftë komuniste” etj., por koha, qartësia politike dhe ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e bënë të tyren. Pra, erdhi një çast kur çdo gjë u bë e qartë. Në Kosovë po bëhej një luftë për t'u çliruar nga një sundim gjakatar mesjetar. Çlirimtarët ishin djem dhe vajza, që e kishin të qartë vizionin e të ardhmes.




Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte tiparet më të spikatura të një ushtrie të kohës tonë. Disa prej të cilave konsideroj: Ajo lindi si një variant proteste për lirinë e Kosovës; lindi si nevojë nga gjiri i popullit të shtypur dhe të persekutuar për të fituar lirinë e shumëkërkuar në shekuj; doli si një forcë serioze për të vendosur drejtësi pa lutje; u krijua si një ushtri që e vendosi bazën e saj në gjirin e popullit të Kosovës dhe e mbështeti shpinën në prehrin e këtij populli, pasi kishte besim të plotë në ecurinë e aktit të saj për liri; u rrit shpejt si një ushtri me disiplinë të vullnetshme, jashtë detyrimeve ligjore dhe disiplinës së forcës; siguroi një popullaritet kombëtar dhe ndërkombëtar si një ushtri demokratike dhe me parametra të besueshëm për ecurinë e rritjes dhe të forcës së saj; ndoqi një taktikë dhe strategji të studiuar mirë dhe arriti të fitojë reputacionin e duhur në sytë e gjithë opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, duke vënë në arsenalin kombëtar edhe një faqe lavdie; vendosmëria për arritjen e synimeve dhe objektivave të luftës ishte një nga tiparet thelbësore të saj; korrektësia në marrëdhëniet me popullin dhe me organizmat politike kosovare e ndërkombëtare, ishte në themel të veprimtarisë ushtarake të të gjitha strukturave të kësaj ushtrie, duke përbërë tiparin që përcaktoi edhe fuqinë e saj; zhdërvjelltësia dhe manovrueshmëria ishin tipare të dinamizmit, me të cilat u rrit ushtria etj.

Po kështu, vlerësoj se Lufta Çlirimtare e Kosovës u zhvillua si një luftë bashkëkohore, karakteristikat e së cilës ishin: kishte një strategji politike dhe ushtarake të përcaktuar saktë dhe me synime të detajuara me përgjegjësi; ishte një luftë e drejtë; kishte tiparet e një lufte mbarëpopullore; ishte një luftë që përfaqësonte interesat kombëtare të popullit në trojet etnike të tij; dallohej për një disiplinë të ndërgjegjshme të të gjithë luftëtarëve; u zhvillua si një kombinim në masën e duhur të luftës partizane me luftën klasike; ishte një luftë që nuk doli për asnjë moment jashtë parametrave të ndeshjes ushtarake dhe nuk mori asnjëherë nuancat e reprezaljeve mbi popullatën civile serbe në Kosovë; u zbatua një taktikë e zhdërvjellët dhe elastike gjatë zhvillimit të betejave; zhvillohej në terrene të njohura dhe etnike; përfshiu gjithë territorin e Kosovës; ishte një luftë vullnetare; nuk njohu kompromise jashtë interesave kombëtare; financiarisht u mbështet vetëm në ndihmën vullnetare të popullit të Kosovës; u paraqit si një luftë me parime të forta morale etj. Në tërësinë e saj, Lufta Çlirimtare e Kosovës ishte një luftë pa kthim, e cila kishte një detyrim historik që duhej ta kryente në kohën e duhur për të siguruar për popullin e Kosovës aspiratën, për të cilën kanë luftuar dhe janë sakrifikuar me dhjetëra e dhjetëra breza trimash të këtyre trojeve. Ushtria çlirimtare që mori mbi shpatullat e veta barrën e rëndë të sigurimit të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, vlerësohet si pionierja e të ardhmes së Kosovës dhe e ringritjes kombëtare shqiptare.

(Vazhdon)

# Trumpi dërgon agjentë federalë në qytetet ku ka rritje të dhunës



Uashington, 23 korrik - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka bërë me dije se do të dërgojë agjentë federalë në më shumë qytete amerikane për të ndihmuar në frenimin e krimit.
Trumpi ka thënë se agjentët do të dërgohen në Allbukërki të Nju-Meksikos dhe në Çikago të Illinoisit. Shumë qytete, përfshirë Nju Jorkun e Filladelfian, kanë parë rritje të krimit, përfshirë dhunën me armë, pas fillimit të protestave mbarëkombëtare për vdekjen e një afrikano-amerikani në duart e policisë në Minesota, në fund të majit. Protestuesit kërkojnë më shumë përgjegjësi nga policia, ndërsa disa bëjnë thirrje për uljen e buxhetit për policinë ose shkarkimin e departamenteve të policisë në formën e tyre aktuale.
Trumpi, i cili pritet të garojë për rizgjedhje në zgjedhjet e nëntorit, tha se rivalët e tij demokratë janë shumë të butë ndaj krimit. "Javët e fundit ka pasur një lëvizje radikale për të mbrojtur, çmontuar dhe shpërbërë departamentin tonë të policisë", ka thënë ai, duke sugjeruar se kjo ka çuar në "një shpërthim tronditës të të shtënave, vrasjeve dhe krimeve të tmerrshme të dhunës". "Kjo gjakderdhje duhet të marrë fund", ka thënë Trumpi. Disa ekspertë kanë thënë se dhuna në rritje është shkaktuar pjesërisht prej zmbrapsjes së policisë nga lufta kundër krimit për shkak të një kontrolli më të madh publik. Krimi në rritje mund të jetë i lidhur me masat e izolimit nga koronavirusi, të cilat kanë bërë që miliona njerëz të mbeten pa punë. Agjentët federalë janë dërguar tashmë në Kansas Siti dhe Portland, ku veprimet e tyre janë kritikuar nga grupet e të drejtave civile dhe demokratët. Qytetet si Çikago fillimisht kanë hedhur poshtë ofertat për agjentë, por me përshkallëzimin e dhunës, autoritetet atje i janë drejtuar qeverisë federale për ndihmë. Në Çikago këtë vit kanë ndodhur 414 vrasje, krahasuar me 275 gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2019.

# Rriten tensionet Turqi - Greqi



Athinë, 23 korrik - Greqia ka bërë me dije se do të bëjë "gjithçka që është e nevojshme" për t'i mbrojtur të drejtat e saj sovrane, kur bëhet fjalë për misionin e kërkimit të naftës dhe gazit në jug të ishujve grekë në Mesdheun Lindor nga ana e Turqisë fqinje. Mosmarrëveshja për të drejtat e pasurive nënujore ka bërë që Turqia dhe Greqia t'i vendosin trupat e marinës në rajon, raporton "Reuters". Të dyja vendet janë anëtare të NATO-s. Një anije kërkimore turke, "Oruc Reis" është duke u përgatitur për një mision studimi, por Greqia po e kundërshton ashpër një projekt të tillë.
Zëdhënësi i qeverisë greke, Stelios Petsas, e ka përshkruar misionin si një shkelje të drejtpërdrejtë të sovranitetit grek. "Qeveria u bënë me dije të gjitha palëve se Greqia nuk do të pranojë një shkelje të sovranitetit të saj dhe do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për t'i mbrojtur të drejtat e saj sovrane", ka thënë Petsas.
Greqia dhe Turqia kanë qenë në mosmarrëveshje për dekada mbi kufijtë detarë, por zbulimet e fundit të gazit natyror dhe planet e shpimit nëpër Mesdheun Lindor kanë përkeqësuar tensionet. Turqia ka thënë se ka të drejtë të vazhdojë me planet e saj. Greqia ka rreth 6 000 ishuj në Detet Egje dhe Jon, më shumë se 200 prej tyre janë të banuar. Në Ankara, presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka vizituar Këshillin Suprem Ushtarak të vendit dhe ka thënë se ai kishte besim të plotë në aftësinë e ushtrisë së vendit të tij. "Suksueset historike në fronte të ndryshme, nga Siria në Libi, nga Mesdheu Lindor deri te lufta kundër terrorizmit, demonstrojnë forcën e vendit tonë dhe aftësitë e forcave tona të armatosura", ka thënë Erdogan.
Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara i kanë bërë thirrje Turqisë t'i ndalë planet e saj për kërkimin e gazit në rajon.

# Pasi i mbijetoi mocionit të mosbesimit, Borisovi bën ndryshime në qeveri




Sofje, 23 korrik (ER) - Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borisov, ka larguar disa ministra, në mesin e tyre tre ministra kyçë të kabinetit qeverisës. Ky riorganizim i qeverisë ka për synim që ta qetësojë situatën, pasi për disa javë me radhë në Bullgari janë organizuar protesta kundër korrupsionit, ku protestuest kanë kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Borisov.
Ndryshimet në qeveri vijnë pasi ekzekutivi i udhëhequr nga Borisov, më 21 korrik, i mbijetoi një mocioni të mosbesimit në parlament. Borisov ka shkarkuar ministrin e Financave, të Ekonomisë si dhe atë të Brendshëm. Këta tre ministra ishin përfolur se u kishin shërbyer interesave të një biznesmenit Delyan Peevski, i cili ka në pronësi media dhe është i lidhur me partinë opozitare MRF.
Borisovi njoftoi se ka shkarkuar, po ashtu, edhe ministrin e Turizmit si dhe ka bërë ndryshime edhe në ministri të tjera. Pas një takimi me partnerët e tij të koalicionit, Borisovi ka njoftuar se në vend të Vladislav Goranovit, tani ministrin e Financave do ta udhëheqë Kiril Ananiev. Konstadin Angelov, që deri më tani ka qenë drejtues i spitalit më të madh në Bullgari, Spitalit Alexandrovska është emëruar ministër i Shëndetësisë.
Hristo Terziiski, që deri më tani ka qenë drejtor i policisë, do ta zëvendësojë Mladen Marinovin në postin e ministrit të Brendshëm. Ndërkaq, Lachezar Borisov ka marrë drejtimin e dikasterit të Ekonomisë. Borisov, po ashtu, ka emëruar për ministre të Turizmit, Mariana Nikolova. Mijëra protestues për më shumë se dy javë kanë protestuar kundër qeverisë së Borisovit, të cilën e kanë akuzuar se po favorizon oligarkë të caktuar. Bullgaria, anëtarja më e varfër e Bashkimit Evropian, po ashtu është anëtarja më e korruptuar në mesin e 27 vendeve të bllokut, ka vlerësuar organizata Transparency International.

## Barnieri: Marrëveshja tregtare Britani e Madhe dhe BE duket e pamundur

Londër, 23 korrik (ER) - Negociatori kryesor i Bashkimit Evropian për Brexit, Michel Barnier, ka thënë të enjten se nënshkrimi i një marrëveshje të re tregtare me Britaninë e Madhe duket e pamundur për shkak të mosgatishmërisë së vendit për të buxhetuar për dy çështje kryesore. "Me refuzimin e saj aktual për t'u përkushtuar ndaj kushteve të konkurrencës së hapur dhe të drejtë dhe për një marrëveshje të ekuilibruar për peshkimin, me Mbretërinë e Bashkuar për të bërë një marrëveshje tregtare, në këtë pikë, nuk ka gjasa. Koha për përgjigje po mbaron shpejt në fusha të rëndësishme si klima, mjedisi, puna dhe ligji shoqëror", ka thënë Barnieri. Kjo deklaratë ka ardhur derisa shefi i negociatorit në Britaninë e Madhe, David Frost, ka thënë se vendi i tij duhet të "përballet me mundësinë" që ajo të mos mund të dakordojë një marrëveshje mbi marrëdhëniet e saj të ardhshme me BE-në deri në fund të vitit 2020.




ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

E rrallë

# Kina nis mision pa pilot në Mars



Kina ka nisur një mision pa pilot në Mars, gjatë të cilit shpreson ta përdorë anijen kozmike për ta studiuar tokën e planetit të kuq. "Tianwen-1", ose "kërkimi i së vërtetës qiellore" është nisur me transportuesin e raketave "Long March 5" nga qendra Uençang, në provincën Hainan. Pamjet televizive kanë treguar një ngritje të suksesshme, e cila është ndjekur nga qindra njerëz. Pajisja e Kinës do të marrë shtatë muaj kohë për të arritur në Mars. Ky është fluturimi i dytë për në Mars këtë javë, pasi një anije kozmike e Emirateve të Bashkuara Arabe u nis nga Japonia, më 20 korrik. Shtetet e Bashkuara pritet ta nisin anijen e tyre në Mars javën e ardhshme. Kjo është përpjekja e dytë e Kinës për në Mars. Në vitin 2011, një anije kineze që shoqëronte një mision rus, ka humbur, pasi nuk ka arritur të dalë nga orbita e Tokës dhe është djegur në atmosferë.

FOTO E DITES




Liverpooli ngre kupën pas 30 vjet pritjeje.

## BARSOLETA E DITËS



**Kamerieri dhe uji**

**Mysafiri: Kamerier, a ka ujë?**
**Kamarieri: Po zotëri, sa të duash.**
**Mysafiri: Atëherë ma sill një peshqir se po hyj të lahem.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



E jashtëzakonshme

# 800 milionë vjet më parë një dush masiv asteroid goditi Tokën dhe Hënën

Gjatë rrjedhës së historisë antike të Tokës, planeti ynë është ndezur me një larmi objektesh të huaja, disa prej të cilave mund të kenë shkaktuar ngjarje të mëdha që formojnë këtë vend që tani e quajmë shtëpi. Sipas një studimi të ri, një incident i tillë ishte edhe dushi masiv asteroid që bombardoi Tokën dhe Hënën 800 milionë vjet më parë. Gjatë këtij dushi monstruoz, asteroidet që janë përplasur me Tokën ishin shumë më të mëdha se asteroidi përgjegjës për zhdukjen e dinozaurëve, 66 milionë vjet më parë, besojnë studiuesit. Ekzistojnë gjithashtu prova që një dush asteroid që preku Tokën 470 milionë vjet më parë mund të ketë shkaktuar një rënie të nivelit të detit, kushteve të akullta dhe të kontribuonte në biodiversitet. Më herët se 66 milionë vjet më parë, edhe krateri i ndikimit Chicxulub, nën Gadishullin Yucatan në Meksikë dhe i vendosur në det të hapur pranë qytetit Chicxulub, u formua kur një meteorit i madh midis 6.8 dhe 50.3 milje në diametër goditi Tokën. Kjo ngjarje e zbuluar rishtazi, që ndodhi 800 milionë vjet më parë, përfshinte dush asteroid me një masë totale 30 deri 60 herë më shumë se ai i asteroidit që e krijoi Chicxulub.



**DASHI**
Do ta kuptoni më mirë gjatë kësaj dite se marrëdhënia në çift nuk i përmbush të gjitha objektivat e duhura, prandaj mund të merren vendime me rëndësi.



**DEMI**
Ditë e veçantë kjo e nesërmja për të gjithë ata që janë në një lidhje. Do të merreni vesh për mrekulli me parterin tuaj dhe do të argëtoheni pa fund së bashku.



BINJAKËT
Do t'i jepni rëndësinë e duhur jetës suaj në çift dhe gjithçka do të shkojë ashtu si e kishit ëndërruar. Nuk pritet të ndodhë asgjë e keqe. Me financat duhet të bëni kujdes maksimal.



GAFORRJA
Ditë goxha e ten-sionuar pritet të jetë kjo e nesërmja për ata që janë në një lidhje. Gjithsecili do të kërkojë të dalë e tij dhe askush nuk do të hapë rrugë.



**LUANI**
Sot do të jetë më e qetë për ata që janë në një lidhje. Më në fund do t'i sqaroni mosmarrëveshjet e vogla që keni pasur dhe do të jeni më të qetë.



VIRGJËRESHA
Pesimizmi juaj nesër në jetën sentimentale do të jetë tërësisht i pajustifikuar. Nëse mbylleni në vetvete keni për ta humbur njëherë e përgjithmonë partnerin. Mos bëni gabime të tilla.



**PESHORJA**
Do t'i keni të njëjtat ide dhe mendime me partnerin tuaj dhe do të bashkëpunoni për gjithçka me të. Dita do të jetë plot diell dhe e mbushur me emocione. Me pak fjalë, dikë fantastike.



**AKREPI**
Do të keni probleme goxha të mëdha gjatë kësaj ditë në jetën tuaj në çift dhe do të ndiheni shpeshherë keq.



SHIGJETARI
Do të përballeni me shumë zhgënjime, juve që jeni në një lidhje dhe do të vuani tej mase. Sikur të kishit bërë kujdes më parë, nuk do të përballeshit me një situatë të tillë.



**BRICJAPI**
Nëse mbylleni në vetvete keni për ta humbur njëherë e përgjithmonë partnerin. Pesimizmi juaj nesër në jetën sentimentale do të jetë tërësisht i pajustifikuar.



**UJORI**
Do të tregoheni shumë i hapur dhe i disponueshëm ndaj partnerit gjatë kësaj dite. Marrëdhënia në çift nuk do të ketë asgjë për çfarë të shqetësoheni.



**PESHQIT**
Do t'i shtoni dozat e intimitetit në çift gjatë kësaj dite dhe do të kaloni çaste të lumtura në krahët e partnerit. Shumë gjëra kanë për të qenë ndryshe për ju.

# Berluskonit i kushton shtrenjtë ndarja nga e dashura



Ish-kryeministri italian Silvio Berlusconi edhe pse tashmë mbush 84 vjeç, vazhdon të ketë një jetë aktive në fushën e romancave. Prej pak muajsh, ai ka nisur një lidhje me deputeten 30-vjeçare Marta Fascina. Ai la 36-vjeçaren Francesca Pascale, për t'u lidhur me deputeten e partisë së tij. Por kjo ndarje duket se i ka kushtuar jo pak, por 20 milionë euro. Sipas Corriere, Berlusconi ia ka dhënë këtë shumë ish të dashurës së tij, si një tip "shpërblimi" për prishjen e marrëdhënies së tyre, e cila nisi në vitin 2012.

# Meek Mill u përgjigjet akuzave të Kanye Westit, tregon a ka fjetur me Kimin



Meek Mill gati sa nuk është bërë shkak që Kanye West dhe Kim Kardashian të ndahen, shkruajnë mediat e huaja. Meek i ka mohuar akuzat e Kanye kinse ka fjetur me Kimin dhe ka thënë se këto janë gënjeshtra me brirë. Në një sërë postimesh në llogarinë e vet në "Twitter", Kanye la të kuptohej se gruaja e tij kishte kryer marrëdhënie intime me Meekun dhe për këtë ai ka dashur të shkurorëzohej nga Kimi dy vjet më parë. Milli është treguar disi i përmbajtur me reagimin e tij, duke bërë një postim në "Twitter" për të mohuar gjithçka: "Oh gënjeshtra me brirë"!




# Rita Ora duket se ka problem me bartjen e reçipetave

Këngëtarja e njohur shqiptare, Rita Ora, shpeshherë publikon foto të reja në llogarinë e vet në "Instagram". Ajo me ndjekësit ndan imazhe të ndryshme ku shfaqet seksi me veshje të ndryshme, mirëpo ajo se çfarë ka rënë në sy ka qenë fakti se pothuajse gjithmonë e shohim duke mos bartur reçipeta. Duhet kujtuar se Rita konsiderohet si një ndër këngëtaret më seksi dhe këtë e ka dëshmuar shumë herë.

# Fejohet Demi Lovato



Këngëtarja me famë botërore, Demi Lovato, është fejuar me aktorin Max Ehrich. Lajmin e ka bërë me dije vetë Demi përmes një postimi në "Instagram", ku ka publikuar disa foto përkrah partnerit të saj nga ceremonia e fejesës e organizuar në bregdet. Demi në postimin e saj shkruan se ajo është zyrtarisht partnerja e Max. "Kur isha vajzë e vogël, babai im gjithmonë më quante partnerja e tij të vogël. Diçka që mund të dukej e çuditshme, por për mua ka kuptim të përsosur. Dhe sot ajo fjalë ka kuptim të përsosur përsëri. Sot zyrtarisht jam partnerja e dikujt tjetër", ka shkruar Lovato.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Fazliu për tri vjet fitoi tre trofe: Synojmë suksese në Ligën e Kampionëve

Astrit Fazliu ka fituar tre tituj të kampionit për tri vjet rresht, kurse tash me skuadrën e Dritës synon suksese të reja në garat e Ligës së Kampionëve. "Në sezonin tjetër do të hyjmë me qëllim të njëjtë, që ta fitojmë titullin, pse jo edhe Kupën. Besoj se do të arrijmë suksese edhe në të ardhmen, kurse sa i përket pjesëmarrjes në garat e Ligës së Kampionëve, tash kemi përvojë më të madhe dhe shpresojmë të shkojmë sa më lart që është e mundur", ka thënë Fazliu

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Sulmuesi Astrit Fazliu është një nga futbollistët më të suksesshëm në futbollin e Kosovës, pasi vetëm në tre vjetët e fundit ka fituar tre tituj të kampionit, kurse ai ka fituar edhe trofe të tjerë gjatë karrierës futbollistike. I kontaktuar të enjten nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Astrit Fazliu ka thënë se ndihet krenar me suksesetе e arritura, sidomos në vitet e fundit, për faktin se jo shumë futbollistë arrijnë suksese të tilla. "Tre tituj kampionë tre vjet rresht, normalisht se përbëjnë sukses për t'u krenuar sepse jo shumë futbollistë e kanë fatin e tillë. Këto suksese nuk janë të rastësishme. Po arrihen me punë dhe sakrificë dhe normalisht se po ndihem shumë i lumtur për faktin se është një sukses që nuk arrihet lehtë", ka thënë Fazliu, i cili më pas ka treguar për suksesetе e tjera që ka arritur.

Sulmuesi me përvojë të madhe ka luajtur edhe për Prishtinën, Ferizajn, Feronikelin dhe ka bërë karrierë edhe në futbollin e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë. "Deri tash kam fituar pesë tituj të kampionit, dy Kupa dhe tri Superkupa", ka shtuar ai.

Fazliu në janar i është bashkuar Dritës me kontratë njëvjeçare, derisa synim ka që me këtë skuadër t'i vazhdojë



suksesetе në arenën vendore, por edhe në garat ndërkombëtare. Fazliu ka thënë se qëllimi i skuadrës nga Gjilani është të shkojë sa më lart në garat e Ligës së Kampionëve.

"Në sezonin tjetër do të hyjmë me qëllim të njëjtë, që ta fitojmë titullin, pse jo edhe Kupën. Besoj se do të arrijmë suksese edhe në të ardhmen, kurse sa i përket pjesëmarrjes në garat e Ligës së Kampionëve, tash kemi përvojë më të madhe dhe shpresojmë të shkojmë sa më lart që është e mundur", ka thënë Fazliu.

Astrit Fazliu së bashku me Kastriot Rexhën ishin lojtarë kyçë në sukseset e Feronikelit në kampionatin e kaluar, por në afatin kalimtar të janarit ata u lanë të lirë me arsyen se klubi i shihte të panevojshëm. Që të dy këta futbollistë u rikthyen në skuadrën e Dritës dhe arritën të shpallen kampionë, kurse tash Fazliu ka një porosi për trajnerët që e larguan nga "Nikli". "Feronikelin nuk kam çka e komentoj, pasi aty kemi pasur gjithë respektin dhe ka pasur shumë njerëz që kanë qarë kur ne jemi larguar. Trajnerët Albert Bunjaki me Agim Sopin kur erdhën na thanë se për tri vjet do të futen në grupet e Ligës së Kampionëve, por mirë që i larguan më herët se me ata Feronikeli do të rrezikohej të binte nga Superliga, ndërsa ne u bëmë kampionë me Dritën", ka deklaruar Fazliu.

Drita ndeshjen e fundit të kampionatit do ta zhvillojë ndaj skuadrës së Ballkanit në Suharekë.

# Kabashi: Tash ka filluar gara e vërtetë për Ballkanin

SUHAREKË, 23 KORRIK - Presidenti i skuadrës së Ballkanit, Arsim Kabashi, nëpërmjet një shkrimi publikuar në profilin e vet në "Facebook", ka thënë se tash fillon gara e vërtetë për klubin nga Suhareka. Ai ka konfirmuar se ka pak rëndësi fakti se a do ta sigurojë Ballkani daljen në Evropë apo do ta fitojë Kupën. "Të dashur qytetarë të mirë të vendlindjes sime Suharekës, të dashur tifozë të klubit tonë. Ne ju zhgënjyem në fund për ta sjell titullin e parë në historinë e klubit, ishim më të motivuar se gjithçka, u munduam me të gjitha forcat, dhamë gjithçka nga vetja, por ishte e




shkruar kështu nga Zoti i madhërishëm. Për mua si udhëheqës i klubit tani më s'ka rëndësi a do ta sigurojmë Evropën apo do të jemi fitues të Digitalb Kupës së Kosovës, do të fokusohemi në kampionatin e ardhshëm, tani ka filluar gara e vërtetë për FC Ballkanin. Krenar dhe mirënjohës për punën e palodhshme të supertrajnerit Munishi dhe stafit të tij, krenar dhe falënderues për gladiatorët tanë që dhanë gjithçka nga vetja për një triumf të vërtetë", ka shkruar Kabashi, i cili e ka uruar edhe skuadrën gjilanase për titullin kampion: "Dua t'i uroj titullin e kampionit presidentit të Dritës, Valon Murselit dhe FC Dritas! Urojmë të na bëni krenarë shtetin tonë në garat evropiane".

## SHKURT

### Tottenhami dhe WBA-ja vazhdojnë garën për Muriqin

Dy klubet angleze, Tottenham Hotspur dhe West Bromwich Albioni, po e vazhdojnë garën për sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi. Fenerbahçe po planifikon ta shesë 26-vjeçarin këtë verë dhe klubi turk do të përpiqet të nxjerrë sa më shumë para nga shitja e tij. E përditshmja turke "Sabah" raporton se klubi nga Stambolli i kërkon 20 milionë euro për Muriqin. Interesim për Muriqin kanë shfaqur edhe klubet e tjera angleze si Manchester United, Newcastle United, Leicester City, Leeds United, Southampton, Brighton e Burnley. Sulmuesin shtatlartë e duan edhe klubet italiane Lazio dhe Napoli.

### Batatina apelon: Të kryhen më shpejt punimet në stadiumin 'Zahir Pajaziti'

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, është shprehur i brengosur për punët e ngadalshme që po bëhen në stadiumin "Zahir Pajaziti". Punimet në këtë stadium, sipas trajnerit të Llapit, ishin paraparë të përfundojnë në vitin 2019. "Po shfaq brengën time për ngecjen e punimeve në stadiumin e qytetit 'Zahir Pajaziti', projekti dhe plani dinamik për përfundimin e të cilit ka qenë në vitin që lamë pas. Dua ta shfaq brengën time pasi ne donatorët e klubit jemi duke financuar qindra e mijëra euro në skuadër për çdo vit dhe investimet do të vazhdojnë edhe në vitin e ardhshëm, andaj kërkoj që MKRS-ja dhe Kuvendi Komunal të merren seriozisht që të përfundojë stadiumi i qytetit dhe sezonin e ri 2020/21 ta nisim me stadium të kompletuar", ka thënë Batatina, i cili ka kërkuar edhe nga kryetari i komunës, Nexhmi Rudari, ta marrë seriozisht këtë kërkesë që punimet të vazhdojnë dhe investimet të mos ndalen që të kompletohet stadiumi "Zahir Pajaziti" dhe infrastruktura përcjellëse e tij.

### Lazio vazhdon interesimin për Kumbullën

Edhe pse pandemia e Covid-19 ka penalizuar edhe futbollin, kjo nuk do të thotë se merkato nuk ka. Marash Kumbulla vijon të mbetet në modë në merkaton italiane. Më të interesuarit e momentit për mbrojtësin e përfaqësueses shqiptare janë kryeqytetasit e Lazios të cilët po bëjnë maksimumin për ta mposhtur konkurrencën e Interit. Bardhekaltrit kërkojnë ta mbyllin sa më parë transferimin e 20-vjeçarit në Romë dhe për këtë ka pasur një tjetër takim mes drejtuesve të Veronës dhe Igli Tares. Oferta më e fundit e Lazios është 20 milionë euro, plus futbollistët Andre Anderson dhe Lombardi, propozim që duket i kënaqshëm për të dyja palët.

## Rrahmani e lumtur që do të luajë në ShBA



PRISHTINË, 23 KORRIK - Ëndrra e shumë sportistëve është për të luajtur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë ëndërr do ta realizojë edhe basketbollistja e Kosovës, Agnesa Rrahmani. Ajo ka treguar për hapin e ardhshëm në karrierë. "Pas pesë viteve karrierë së bashku me Kastriotin dhe Kosovën në shumë Kampionate Evropiane, mora vendimin që ta vazhdoj karrierën në Amerikë. Kalimi në ShBA u mundësua nga 'New Sports Agency' që të nënshkruajë kontratë me bursë të plotë në një kolegj në Teksas, pra 'Weatherford College'", është shprehur Rrahmani për faqen zyrtare të FBK-së. Angesa është e gatshme për këtë sfidë. "Kjo për mua do të jetë një sfidë, megjithatë mundësi shumë e mirë që të jetë vazhdim i rrugëtimit tim, duke shpresuar se do të jap më të mirën nga vetja", theksoi Agnesa Rrahmani. Në ShBA, por edhe në ligat evropiane shumë basketbollistë/e paraqiten me sukses dhe këtë rrugë pritet ta vazhdojë edhe basketbollistja e Kosovës.

# Kloppi pas ngritjes së trofeut: Ndjenjë e veçantë

LIVERPOOL, 23 KORRIK - Festë pas 30 vjetëve pritje dhe tani Liverpooli mund ta ngrejë titullin kampion në "Anfield". Fati nuk është treguar aspak dashamirës, pasi e gjithë kjo festë ishte pa tifozë. Në intervistën e dhënë pas ndeshjes ndaj Chelseas të fituar me rezultatin 5-3, Jurgen Kloppi ka folur pas ngritjes së trofeut. "Absolutisht e veçantë, ne nuk e krahasojmë pasi nuk e kemi fituar më parë. Mund të ishte më mirë, por ne e dimë se mund të ishte më keq nëse nuk do të kishim fituar, këta djem janë kaq të veçantë. Pesë vjet më parë iu thashë se duhet të ktheheni nga dyshues në besues. Nëse të gjithë bashkë do të ishim duke festuar. Tani rrini në shtëpi, të sigurt dhe pini çfarë të doni, por përgatituni për festën e madhe", ka thënë Klopp. "Unë nuk mund të jem më krenar për ata pas kësaj paraqitje në fushë në një lojë të hapur me gola të këndshëm. Gola të pabesueshëm, super futboll. Prezantimi i trofeut ishte absolutisht i shkëlqyeshëm, absolutisht. E bëri edhe më të veçantë që familjet mund të ishin në stadium me ne. Ata nuk u lejuan për lojë, por për ngritjen e trofeve u lejuan. Të gjithë të dashurit e mi ishin rreth meje me lojtarët, stafin dhe njerëzit me të cilët punoj. Familja ime do të thotë shumë për mua, kështu që ishte me të vërtetë e veçantë në atë çast. E doja momentin dhe djemtë e bënë. Është e çuditshme, ju qëndroni në një skenë dhe askush nuk është jo askush, por jo aq sa do ta imagjinonit në një situatë si kjo por, më duhet të them, njerëzit që e organizuan e bënë më të mirën", ka shtuar Klopp. Tifozët e Liverpoolit u grumbulluan duke shkelur rregullat e pandemisë në lidhje me distancimin fizik. Madje për tifozët gjatë javës ka pasur edhe një paralajmërim nga policia për të evituar diçka të tillë. Ata u mblodhën jashtë stadiumit dhe nisën festën e tyre me kore e flakadanë duke injoruar Covid-19. Një festë e madhe, e cila përsëritet për herë të dytë, duke qenë se edhe disa javë më parë kur Liverpuli fitoi matematikisht titullin, tifozët ishin sërish në rrugë duke u grumbulluar në këtë kohë të vështirë.



# Kovaq: Monaco shumë shpejt do të jetë në krye të Ligës 1

MONACO, 23 KORRIK - Niko Kovaq ka nisur një përvojë të re. Ish-trajneri i Bayern Munchenit dhe Eintracht Frankfurtit pak ditë më parë mori zyrtarisht drejtimin e Monacos me kroatin që zëvendësoi në këtë post spanjollin Robert Moreno. Kovaq është i entuziazmuar për këtë aventurë të re dhe kjo u duk qartë në fjalët e tij të para si trajner i Monacos. "Çdo trajner sjell me vete filozofinë e tij, mënyrën sesi ai e shikon lojën. Në të kaluarën kam drejtuar Bayernin dhe Eintrachtin, dy skuadra me stile të ndryshme. Duhet të përshtatemi, ta shikojmë si është skuadra, lojtarët dhe t'i zgjedhim taktikat



më të mira. Objektivi është ta kthejmë Monacon në majën e Ligës 1 dhe duam ta bëjmë sa më shpejt. Të gjithë lojtarët duhet të përmirësohen, por kam besim te ata. Do të jemi atje ku duam sa më shpejt që të jetë e mundur", ka thënë Kovaq.

## SHKURT

### Zidane do të jetë trajner i Realit edhe në vitin e ardhshëm

Zinedine Zidane do të qëndrojë te Reali i Madridit edhe për sezonin e ardhshëm. Duke iu referuar asaj që shkruan gazeta madrilene "Marca", presidenti Florentino Perez dhe tekniku francez kanë biseduar mes tyre pas përfundimit të kampionatit dhe është zyrtarizuar vazhdimësia e Zinedine Zidane në stolin e "Los Blancos". Fitimi i titullit të 34-t në historinë e klubit ka shuar çdo dyshim për sa i përket të ardhmes së Zidanes, me presidentin Perez që në një intervistë ka përdorur fjalë të ëmbla për trajnerin francez. "Zidane është një bekim për Realin e Madridit", ka deklaruar Perezi kur skuadra fitoi matematikisht titullin kampion.

### Marquezi rikthehet në garën e Jerezit

Marc Marquez është një luftëtar i vërtetë që nuk e ndalin as aksidentet. Edhe pse fluturoi në ajër në garën e parë sezonale dhe u detyrua të operohej për ta shmangur frakturën në shpatull, kampioni në fuqi i botës është rikuperuar në kohë rekord dhe do të zbresë në pistë këtë fundjavë në garën e Çmimit të Madh të Jerezit në Spanjë. Me një postim në rrjetet sociale të Hondas zyrtare janë konfirmuar zërat që kanë qarkulluar në media pasditen e të mërkurës. Vetëm ditën e djeshme Marquezi ka dalë nga klinika në të cilën ishte shtruar në Barcelonë dhe rikthimi i tij në pistë pas disa ditësh konsiderohet si një mrekulli e vërtetë.

### Emery emërohet trajner i Villarrealit

Unai Emery është emëruar trajner i Villarrealit me kontratë trevjeçare. Ish-trajner i Sevillas dhe Valencias ka qenë pa angazhim pas largimit nga posti i menaxherit në Arsenal në nëntor. Ish-trajneri i Villarrealit, Javier Calleja, u largua nga detyra javën e kaluar pasi skuadra përfundoi në pozitën e pestë në La Ligë duke siguruar kualifikimin për në edicionin e ardhshëm në Ligën e Evropës.

### Rummenigge: Thiago dëshiron të largohet nga Bayerni

Karl-Heinz Rummenigge ka bërë me dije se Thiago Alcantara dëshiron të largohet nga Bayern Muncheni. "Thiago dëshiron të largohet, por ne nuk po hasim me asnjë klub tjetër momentalisht për shitjen e tij", ka thënë zyrtari i Bayernit, Karl-Heinz Rummenigge. Mesfushori spanjoll do ta mbyllë kapitullin e Bundesligës për t'i provuar emocionet në një kampionat tjetër, por nuk dihet ende se ku do të përfundojë Thiago. Ish-lojtari i Barcelonës do të luajë dhe Ligën e Kampionëve me bavarezët dhe me shumë mundësi do t'i japë fund aventurës së tij. Liverpooli ka dalë së fundmi në skenë.

### Modriq: Ramosi është mbrojtësi më i mirë në botë

Mesfushori i Real Madridit, Luka Modriq, e ka përshkruar Sergio Ramosin "fenomenal" dhe ka thënë se kapiteni i Realit është mbrojtësi më mirë në botë. "Vëllai im Sergio është fenomenal. Nuk po e them këtë vetëm pse e kemi ndërtuar një shoqëri të veçantë në këta tetë vjet, pasi që shkojmë në pushime bashkë si familje, apo vetëm pse kemi pasur përvoja dhe suksese fantastike së bashku", ka thënë Modriq. "Ramosi është një yll 34-vjeçar, një garues i nivelit më të lartë dhe kur e shikon atë duke punuar me veten, është e qartë se sa i përkushtuar është ai dhe sa i uritur është për suksese. Ai është një lider i skuadrës dhe mbrojtësi më i mirë në botë", ka deklaruar Modriqi.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**
**01.Nr.** 01-45/20
**Data:** 23.07.2020

**Komuna e Ferizajt**
**Opština Urosevac**
**Municipal Ferizaj**

Në bazë të Nenin 16 të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L – 106 dhe Rregullores Nr. 05/2014 dhe 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve, Komuna e Ferizajt shpall.

**KONKURS**
**Për aktorë rezident në Teatrin e Qytetit "Adriana Abdullahu"**

**Institucioni: DKRS/ Teatri i Qytetit "Adriana Abdullahu"-Ferizaj**
**1. Titulli i pozitës: Aktor/e**
**Nr. i pozitave: 8 (tetë)**
**Grada/koeficienti aktual 7.00**
**I përgjigjet: Drejtorit të përgjithshëm dhe Udhëheqësit Artistik të Teatrit**
**Orari i punës: i plotë 40 orë në javë**

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Të mësoj tekstin dhe të mbajë prova;
- Të hulumtoj dhe lexojnë material apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që të ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tij
- Të diskutoj interpretimin dhe të shfaq kreativitet dhe kolektivisht në bashkpunim me të tjerët dhe regjisorin;
- Të përformoj drejtpërsëdrejti para publikut;
- Të përformoj në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- Të incizoj zëra varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të kujdeset për hapësirën përformuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të mbaj mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- Studion veprën dhe punon në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin dhe trans pozicionimin e rolit;
- Bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes për të rrumbullakuar rolin;
- Për punën e tij i përgjigjet regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të përgjithshëm
- kryen edhe punë tjera në bazë të udhëzimeve të drejtorisë të teatrit.

**Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Arteve – DAD - aktrim .
- Të kenë së paku tri vjet përvojë pune aktive në realizimin e roleve në Teatër (Përparësi do të kenë kandidatët që kan qenë të angazhuar në realizimin e roleve në teatrin e Ferizajt);
- Të dëshmojë talentin dhe përvojën e tij para audicionit që e organizon Komisioni profesional i Teatrit "Adriana".
- Të njohë gjuhen shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar, e domosdoshme dhe gjuhët tjera zyrtare, njohja e gjuhëve të huaja përparësi;
- Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër-njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.
- Njohuria e punës me kompjuter, Word, Excel;

Përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë banor të Ferizajt dhe jetojnë në Komunën e Ferizajt.
Përzgjedhja e aktorëve për ansamblin rezident bëhet përmes audicionit.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Ligji për Teatrot Nr. 04/L – 106, Rregullorja Nr. 05/2014 dhe Nr.04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Aktorët që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar të paraparë me Rregulloret e me sipërcekura.

**Dokumentet e nevojshme që kërkohen:**

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuar si vijon:
1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë në fotokopje e noterizuar, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar në MASHT.
2. Dëshmi mbi përvojën e punës,
3. CV-në e tij / saj
3. Dokumentin e identifikimit
4. Çertifikata që nuk jeni nën hetime
5. Çertifikata e vendbanimit

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ), në objektin e komunës.
**Afati i aplikimit në QSHQ zgjatë 15 ditë, nga dita e publikimit në gazetë ditore, Web faqe komunale dhe Tabelën e shpalljeve komunale edhe atë: nga data 23.07.2020 deri më datë 06.08.2020, ora 16⁰⁰.**
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë ligjor nuk do të shqyrtohen, kurse ato të mangëta refuzohen.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen përmes tel ose email të cilin duhet shënuar në aplikacion.

Kryetari i Komunës
Agim Aliu

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**
**01 Nr.** 01-45/20
**Datum.** 23.07.2020

**Komuna e Ferizajt**
**Opština Urosevac**
**Municipal Ferizaj**

Na osnovu člana 16. Zakona o pozorištima br. 04 / L - 106 i Pravilnik br. 05/2014 i 04/2019 o osnivanju i funkcionisanju Rezidencijalnog ansambla nacionalnih i gradskih pozorišta, opština Uroševac objavljuje.

**KONKURS**
**Za rezidencijalne glumce u Gradskom pozorištu „Adriana Abdullahu"**

**Institucija: DKOS/ Gradsko pozorište "Adriana Abdullahu"- Uroševca**
**1. Naziv položaja: Glumac/a**
**Br. položaja: 8 (osam)**
**Gradacija/trenutni koeficijent 7.00**
**Odgovara: Generalnom direktoru i Umetničkom rukovodiocu pozorišta**
**Radno vreme: puno radno vreme 40 časova nedeljno**

**Zadaci i odgovornosti:**

- Da nauči tekst i održava probe;
- Da istražuje i pročita materijal ili preduzima fizičke i intelektualne aktivnosti kako bi lakše pripremio svoju ulogu;
- Da razgovara o interpretaciji i prikaže kreativnosti i kolektivno u saradnji sa drugima i rediteljem;
- Da nastupa direktno pred javnošću;
- Da nastupa u studiju ili na drugoj lokaciji u zavisnosti od potreba produkcije;
- Da snima glasove u zavisnosti od potrebe produkcije;
- Da vodi računa o prostoru za performanse, kostimima i rekvizitima;
- Da zapamti tekst i sve druge funkcije dela dok to delo službeno ne napusti repertoar ili kako je određeno u ugovoru;
- Proučava delo i kreativno radi za umetničku realizaciju u izradi i premeštanju uloga;
- Sarađuje direktno sa rediteljem predstave kako bi zaokružio ulogu;
- Odgovoran je za svoj rad režiseru, inspicijentu, umetničkom rukovodiocu i generalnom direktoru;
- Obavlja i druge poslove prema uputstvima pozorišne direkcije.

**Traženi uslovi i veštine:**

- Univerzitetska diploma, Fakultet umetnosti – DAD - gluma.
- Da ima najmanje tri godine aktivnog radnog iskustva u realizaciji uloga u Pozorištu; (Prioritet će imati kandidati koji su bili angažovani u igranju uloga u pozorištu Uroševca);
- Da dokaže svoj talenat i iskustvo pre audicije koju je organizovala Profesionalna komisija pozorišta „Adriana".
- Poznavanje albanskog jezika na odličnom nivou u pisanju i čitanju, neophodno i druge zvanične jezike, znanje stranih jezika je prednost;
- Da ima dobre međuljudske komunikacijske veštine i da bude spreman da radi fleksibilno radno vreme.
- Poznavanje rada na računaru, Word, Excel;

Prednost će imati kandidati koji su stanovnici Uroševca i žive u opštini Uroševac.

Izbor glumaca za rezidencijalni ansambl vrši se putem audicije.

**Uslovi učešća na konkursu:** Pravo na konkurisanje imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost za delovanje, imaju odgovarajuće obrazovanje i imaju profesionalne veštine za obavljanje svojih dužnosti.

**Pravni i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:** Zakon o pozorištima br. 04 / L - 106, Uredba br. 05/2014 i Br.04 / 2019 o uspostavljanju i funkcionisanju Rezidencijalnog ansambla nacionalnih i gradskih pozorišta.

**Trajanje imenovanja:** Glumci primljeni putem javnog konkursa dobijaju dvogodišnje ugovore sa mogućnošću produžavanja, u skladu sa uspehom i posvećenošću datom gore navedenim propisima.

**Zatražena dokumenta koja su potrebna:**

Kandidati moraju ispuniti kompletirane dokumente na sledeđi način:

1. Dokaz o školskoj kvalifikaciji u overenoj fotokopiji, ako je kandidat završio obrazovanje van Republike Kosovo, diploma mora biti overena u MONT-e.
2. Dokaz o radnom iskustvu,
3. Njegov/njen CV
3. Dokumenat identifikacije
4. Uverenje da niste pod istragom
5.Certifikat o mestu stanovanja

Prijave se primaju i popunjene se dostavljaju u Centru za usluge građanima (CUG), u zgradi opštinske uprave.
**Rok za prijavu u CSG traje 15 dana, od dana objavljivanja u dnevnim novinama, opštinskom vebsajtu i opštinskoj tabeli za obaveštenje, i to: od 23.07.2020 do 06.08.2020, do 16⁰⁰.**
Prijave podnete nakon zakonskog roka neće se razmatrati, dok će one nepotpune biti odbačene.
Samo kandidati koji su ušli u uži izbor biće kontaktirani telefonom ili e-poštom koji moraju biti zabeleženi u prijavi.

Gradonačelnik Opštine
Agim Aliu










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Vjollca Hamiti , shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ Arben Sadiku, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nazim Gafurri" Prishtinë.

▶ Nebih H. Ademi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810935570.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

**REPUBLIKA KOSOVËS**

**KOMUNA ZVEÇAN**

Në bazë të nenit 8. Paragrafi 1 i Ligjit të Punës nr. 03 / L-212, Neni 3. Paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Punësimit në Sektorin Publik (Nr.07 / 2017), Komuna Zveçan, me datë 24.07.2020, shpall:

## KONKURS
## PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE

**Departamenti për Arsim**

| | |
|---|---|
| 1. Emri vendin e punës: | Zyrtar administrativ ne edukim |
| Vendi i Punës : | Arsimim themelor |
| Kushtet: | Shkolla e mesme e kryer |
| Orët e punës: | 40 orë në javë |
| Numri i ekzekutuesve: | 2 |

**Periudha e nënshkrimit të kontratës: Periudha provuese prej 6 (gjashtë) muajsh, me mundësi vazhdimi kontratës.**

**INFORMACIONE TË PËRGJITHËSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURENCES**

**Dokumentacioni i kërkuar:**

• Aplikacioni (merret ne zyren nr 33 ne komunen e Zveçanit)
• Kopja e diplomës ( e vertetuar nga noteri)
• Certifikata e përvojës së punës.
Kopja e certifikatës së dhënies së provimit të avokatit - nëse kërkohet (e noterizuar)
• Dy rekomandime (nëse ka).
Kopja e dy raporteve të fundit të vlerësimit të performancës (nëse ka)
• Konfirmimi se ai nuk ishte nën hetim dhe nuk u dënua për një vepër penale.
• Kopja e kartës së identitetit.
• Çertifikatat.

Informata të detajuara për të gjitha pozicionet me përshkrime të vendeve të punës, kualifikimet e kërkuara, përvojën e punës dhe aftësitë e tjera mund të merren në zyrën nr. 33 në ndërtesën e komunës së Zveçanit, si dhe në faqen e internetit të komunës www.eopstinazvecan.com.
**Konkursi mbetet i hapur për 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 24.07.2020. deri më 08.08.2020.**

Kërkesat e dërguara pas mbylljes së konkursit nuk do të merren në konsideratë. Kërkesat e paplotësuara mund të refuzohen. / Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen /
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, do të kontaktohet përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumente origjinale të kualifikimit dhe trajnime.vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Në rast të moskryerjes së dokumentacionit origjinal, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.
"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/
"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtaret e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"
Aplikacionet mund të merren- shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Zyrën nr. 33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit - rruga Kralj Milutini p.n. në periudhën nga ora 8:00 deri në orën 14:00

**REPUBLIKA KOSOVA**

**OPŠTINA ZVEČAN**

Na osnovu člana 8. Stav 1. Zakona o radu br. 03/L-212, člana 3. Stav 1. Administrativnog uputstva za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru (Br.07/2017), Opština Zvečan, dana 24.07.2020. godine objavljuje:

## KONKURS
## ZA PRIJEM U RADNI ODNOS

**Odeljenje za obrazovanje**

| | |
|---|---|
| **1.** Naziv radnog mesta: | Administrativni radnik u prosveti |
| Radno mesto: | Osnovno Obrazovanje |
| Uslovi: | Završena srednja škola |
| Radno vreme: | 40 časova nedeljno |
| Broj izvršilaca: | 2 |

**Period potpisivanja ugovora: Probni period od 6 (šest) meseci, sa mogućnošću produženja ugovora.**

**OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDUROM KONKURISANJA**

**Tražena dokumentacija:**

- Aplikacija (preuzima se u kancelariji br.33 u zgradi opštine Zvečan)
- Kopija diplome (overena od strane notara)
- Kopija uverenja o položenom pravosudnom ispitu-ukoliko se traži (overeno od strane notara).
- Potvrda o radnom iskustvu.
- Dve preporuke (ako imate).
- Kopija dva poslednja izveštaja o vrednovanju rada (ako takve postoje).
- Potvrda da nije pod istragom i da nije osuđivan za krivično delo.
- Kopija lične karte.
- Sertifikati.

Detaljne informacije o svim pozicijama sa opisom posla, traženim kvalifikacijama, radnim iskustvom i ostalim veštinama, možete dobiti u kancelariji br. 33 u zgradi opštine Zvečan kao i veb stranici opštine *www.eopstinazvecan.com*

**Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 24.07.2020.god. do 08.08.2020.god.**
Zahtevi poslati nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni
Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor, biće kontaktirani putem (e-maila) ili u nedostatku potvrđivanja email-om od strane kandidata, biće obavešteni putem telefona i dužni su da ponesu sa sobom originalna dokumenta o kvalifikacijama i izvršenim obukama. U slučaju ne dostavljanja originalne dokumentacije, kandidati će biti isključeni iz regrutacione procedure.
Civilna služba Kosova pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.
Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno i Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.
Aplikacije se mogu preuzeti i podneti svakog radnog dana u Kancelariji broj 33 u zgradi opštine Zvečan – ulica Kralja Milutina b.b. u periodu od 8:00 do 14:00 časova